

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7770 E martë 22 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga JORGJI KOTE



Kushdo që ka shërbyer në diplomaci e di se përfundimi i punëve/dosjeve të caktuara kërkon kohën e vet. Madje, diplomacia shquhet pikërisht për ...
Vijon në faqen 20

"Kantier" diplomatik me shumë punë të pambaruara

Opinion i Ditës

Nga KLODIAN MUÇO



Ekziston një konsensus shumë i gjerë jo vetëm ndërmjet studiuesve të ndryshëm, por edhe organizmave ndërkombëtarë se GDP-ja nuk është treguesi ...
Vijon në faqen 21

Pse kemi rritje ekonomike pa zhvillim



Lehtësira për shkollimin profesional

Punë për emigrantët, ekspertja gjermane: Diploma s'është kusht për lejen e qëndrimit

Ligji i ri/ Punëkërkuessit nga Ballkani, të njëjtat të drejta si personat që vijnë nga vendet e BE

'Deutsche Welle': Ligji i ri për fuqinë punëtore që miratoi kabineti gjerman e që hyn në fuqi më 1 janar 2020 për shumë veta nga Shqipëria e Kosova është si premtim për një jetë më të mirë, punë në Gjermani, e ardhme më e mirë, a mendoni edhe ju kështu? Dr. Carola Burkert: Ligji i ri për fuqinë punëtore ka njëherë si qëllim ...
Në faqen 11

TABELAT/ PD-LSI, PAGA TE REDUKTUARA 30-90 MIJE LEKE. "NISIM REVOLTAT"

BOJKOTI I KUVENDIT, RUCI I MBAN RROGAT OPOZITËS

Rama bëhet ministër i Jashtëm me 78 vota: Sa të ketë PS, s'vini në pushtet. Basha: Je bërë si Enveri, ministrat kukulla. Gjykata e Tiranës dënon kreun e PD për shpifje



(Në foto) Kryetari i PD, Lulzim Basha dhe deputetët e PD duke u larguar nga seanca e djeshme parlamentare

Në faqen 2-4

KONCESIONI

Qeveria anulon tenderin e Thumanë-Kashar, Balluku: Paratë për arsimin

Në faqen 8

PUNESIMI

220 vende të lira për mjekët, Ministria e Shëndetësisë: Ja si të aplikoni

Në faqet 12-13

MANJA: S'KA EKSPERTIZË

Meta propozon Bahri Shaqirin në krye të KLSH, PS përgatit rrezimin në Kuvend

Në faqen 5

PROTESTA

Studentët në bojkot: Të rrezohet ligji i arsimit, nuk do paguajmë për masterin

Në faqen 10

"ESKOBARI"



Mediat italiane: Tri arsyet që sollën dorëzimin e Klement Balilit

Në faqen 7

Shërbimi Social Shtetëror: Brenda muajit merret vendimi sipas sistemit të pikëzimit

Ndihma ekonomike, kategoritë që e përfitojnë

E marrin 53 mijë familje, zbardhen rastet kur përjashtohesh nga skema

NGA VOLTIZA DURO

Në 6-mujorin e parë të vitit që lamë pas, rreth 53 mijë familje në mbarë vendin u bënë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike. 'Gazeta Shqiptare' publikon sot kategoritë që mund të marrin këtë pagesë nëse plotësojnë kriteret



e paracaktuara, mënyrën e aplikimit si dhe ankimimin e vendimit kur ky i fundit nuk rezulton pozitiv për aplikuesit. Përkatesisht ndihmën ekonomike mund ta përfitojnë familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme; jetimet të cilët ...
Në faqen 9

KUVENDI VOTIMI

Basha, Berisha dhe Kryemadhi më të favorizuarit, kanë marrë më shumë lekë për dhjetorin

Bojkoti i Kuvendit, Ruçi u mban pagën deputetëve të opozitës

Të djathtët kanë marrë paga nga 30 deri në 90 mijë lekë

Ndonëse bojkotin e Kuvendit e konsiderojnë si mjet të luftës politike, deputetëve të opozitës edhe gjatë muajit dhjetor u është dashur të përballojnë penaltitete financiare për shkak të pjesëmarrjes në jetën parlamentare. Kuvendi i Shqipërisë ka publikuar shpenzimet dhe pagat e deputetëve për muajin dhjetor, ku bie në sy sërish vendimi i kryeparlamentarit Gramoz Ruçi për të zbatuar me rigorozitet Rregulloren sa i përket trajtimit financiar me pagë. Siç shihet nga tabela e shpenzimeve, deputetët e opozitës janë penalizuar për çdo mungesë që kanë bërë qoftë sa i përket pjesëmarrjes në komisionet parlamentare, ashtu edhe në komisionet e përhershme. Kështu, 156 mijë lekë që është paga bruto e një parlamentarit në një muaj, deputetët e opozitës gjatë muajit dhjetor janë paguar me vlera minimale që variojnë nga 31 mijë lekë minimumi deri në 90 mijë lekë maksimumi. Kjo, pasi Kuvendi praktikon një formulë të veçantë të pagës, ku deputetët i është caktuar fillimisht një shumë e caktuar që në rastin konkret është 156 mijë lekë dhe më pas kësaj shume i hiqen sigurimet, tatimi dhe i mbahen penaltitetet për çdo mungesë apo mospjesëmarrje në seancë plenare dhe në komisionet e përhershme. Si rrjedhojë e kësaj formule, deputetët që janë penalizuar më shumë gjatë muajit dhjetor janë Dashamir Shehi, Jorida Tabaku, Agron Shehaj, Nadire Meçorapaj, Përparim Spahiu dhe Fatbardha Kadriu. Të gjithë këtyre deputetëve i janë njohur plot 16 mungesa dhe për rrjedhojë paga që kanë marrë në fund ka qenë fare minimale, vetëm 31 mijë lekë. Pas tyre vijnë në radhë Edmond Haxhinasto dhe Edmond Spaho me nga 14 mungesa dhe që kanë marrë vetëm 42 mijë lekë. Bën përjashtim Spaho, i cili ka një pagë më të lartë pasi është kryetar grupi dhe për rrjedhojë ka marrë 59 mijë



Grupi parlamentar i PD-së

PAGA

Siç shihet nga lista, Ruçi nuk ka qenë kaq i ashpër me të gjithë deputetët e opozitës. Kjo pasi drejtuesit kryesorë të opozitës, përfshi kryetarin e PD-së Lulzim Basha, ish-kryeministrin Sali Berisha dhe kryetaren e LSI-së Monika Kryemadhi, kryetari i Kuvendit duket se i ka favorizuar.

Ruçi: Opozita t'i kthehet parlamentit, PS të jetë më bashkëpunuese

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, ka kërkuar nga spektri politik shqiptar parlamentar që në këtë sesion të ri të lërë mënjanë interesat e ngushta politike dhe të bashkohet për t'i dhënë Shqipërisë mundësinë që të çelë negociatat e integritetit. Në fjalën e tij hapëse për këtë sesion të ri parlamentar, Ruçi i bëri thirrje opozitës që t'i kthehet debatit parlamentar. "Unë dëshiroj sinqerisht që debati i munguar i sesionit që kaloi të kompensohet në këtë sesion. Legjitimiteti e përfshirja dhe jo komoditeti, përjashtimi apo vetëpërfshirja e bëjnë një parlament funksional. Prezenca e opozitës e bën sesionin parlamentar më të vështirë, por më produktiv, më konfliktual, por më demokra-



tik, më të trazuar, por më të dobishëm", - tha kryetari i Kuvendit. Ai shprehi bindjen se opozita, duke respektuar alternativën e saj politike, do të bëhet një vlerë e shtuar në segmentin e fundit të rrugëtimit drejt çeljes së negociatave. Ndërkohë që nga ana tjetër, ai i ka bërë apel edhe mazhorancës që të tregohet më bashkëpunuese. "Shumica parlamentare duhet të tregojë më shumë

durim e vullnet për të bashkëpunuar. Duhet të duam dhe të dimë ta shfrytëzojmë shansin që na ka dhënë Këshilli Europian. Nuk e kemi më luksin të biem në kurthin e ambicieve partiake dhe të mos ndriçohemi prej dritës që vjen nga Europa. Mjaft e kemi penguar aspiratën europiane të shqiptarëve me kapriçiot tonal!", - theksoi kryetari i Kuvendit.

lëkë. Më pas vijnë Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Silva Caka, Nasip Naço dhe Astrit Veliaj me nga 13 mungesa dhe me vetëm 47 mijë lekë pagë. Në radhë vijnë deputetët Agron Çela, Flamur Noka, Florion Mima, Gent Strazimiri, Luçiano Boçi, Andon Frrokaj, Endri Hasa, Endrit Brahimllari, Ervin Salianji, Hekuran

Hoxholli, Izmiria Ulqinaku, Isuf Çelaj, Mylsim Murrizi, Lorenc Luka, Luan Baçi, Nora Malaj, Shezai Rokaj, Valentina Duka, Xhemal Gjunksi dhe Lefter Koka me nga 12 mungesa. Të gjithë këta deputetë kanë marrë vetëm nga 53 mijë lekë. Ndërkohë siç shihet nga lista, Ruçi nuk ka qenë kaq i ashpër me të gjithë de-

putetët e opozitës. Kjo pasi drejtuesit kryesorë të opozitës, përfshi kryetarin e PD-së Lulzim Basha, ish-kryeministrin Sali Berisha dhe kryetaren e LSI-së, Monika Kryemadhi, kryetari i Kuvendit duket se i ka favorizuar. Të tre atyre u janë njohur vetëm 4 mungesa, ndërsa janë paguar me 97 mijë lekë të reja.



Dje në seancën parlamentare

PAGAT DHE PENALITETET PËR MUNGESAT E DEPUTETËVE PËR MUAJIN DHJETOR

Emri	Mungesa	Penalitet	Paga
Agron Çela	12	63,852	53,201
Albana Vokshi	10	53,210	69,355
Aldo Bumçi	5	26,605	90,448
Dashamir Shehi	16	85,136	31,917
Edi Paloka	9	47,889	90,845
Edmond Spaho	14	74,494	59,091
Fatmir Mediu	5	26,605	95,960
Flamur Noka	12	63,852	53,201
Florion Mima	12	63,852	53,201
Genc Pollo	5	26,605	95,960
Gent Strazimiri	12	63,852	53,201
Jorida Tabaku	16	85,136	31,917
Kejdi Mehmetaj	11	58,531	58,522
Luan Rama	9	47,889	69,164
Luçiano Boçi	12	63,852	53,201
Monika Kryemadhi	4	21,284	95,769
Nard Ndoka	9	47,889	69,164
Oerd Bylykbashi	13	69,173	47,880
Përparim Spahiu	16	85,136	31,917
Sali Berisha	4	21,284	95,769
Vangjel Dule	5	26,605	90,448
Vangjel Tavo	9	47,889	69,164
Dhurata Çupi	11	58,531	58,522
Petrit Vasili	9	47,889	85,696
Agron Shehaj	16	85,136	31,917
Andon Frrokaj	12	63,852	53,201
Bardh Spahia	9	47,889	69,164
Edmond Haxhinasto	14	74,494	42,559
Endri Hasa	12	63,852	53,201
Endrit Brahimllari	12	63,852	53,201
Enkelejd Alibeaj	13	69,173	47,880
Ervin Salianji	12	63,852	53,201
Fatbardha Kadriu	16	85,136	31,917
Floida Kërpaçi	9	47,889	69,164
Gjetan Gjetani	3	15,963	101,090
Grida Shqina	9	47,889	69,164
Halim Kosova	9	47,889	69,164
Hekuran Hoxhalli	12	63,852	53,201
Isuf Çelaj	12	63,852	53,201
Izmiria Ulqinaku	12	63,852	53,201
Klevis Balliu	9	47,889	69,164
Lindita Metaliaj	9	47,889	69,164
Lorenc Luka	12	63,852	53,201
Luan Baçi	12	63,852	53,201
Lulezim Basha	4	21,284	95,769
Mylsim Murrizi	12	63,852	53,201
Nadire Meçorapaj	16	85,136	31,917
Nasip Naço	13	69,173	47,880
Nora Malaj	12	63,852	53,201
Orjola Pampuri	9	47,889	69,164
Romeo Gurakuçi	12	63,852	53,201
Rudina Hajdari	9	47,889	69,164
Shezai Rrokaj	12	63,852	53,201
Tritan Shehu	9	47,889	69,164
Valentina Duka	12	63,852	53,201
Viktor Tushaj	5	26,605	90,448
Xhemal Gjunksi	12	63,852	53,201
Klajda Gjoshaj	10	53,210	63,843
Lefter Koka	12	63,852	53,201
Edmond Panariti	9	47,889	69,164
Silva Caka	13	69,173	47,880
Astrit Veliaj	13	69,173	47,880



Vetëm pak minuta pasi u votua edhe si ministër i Jashtëm, Edi Rama ka bërë të qartë se beteja ligjore me Presidentin e Republikës do të vazhdojë. Në një prononcim të dhënë për mediat menjëherë pas seancës së mbremshme, Rama është shprehur se socialistët kanë bërë gati një numër padish për shkeljet e presidentit, duke përfshirë dhe mosdekretimin e Gent Cakajt si ministër i Jashtëm. "Ne kemi ngritur një numër padish për një sërë shkeljen nga ana e presidentit dhe për këtë rast (i referohet mosdekretimit të Cakajt). Kjo duhet zgjidhur përfundimisht. Duroni se do të bëj betimin, pastaj do të vazhdoj me të tjerat", tha Rama. Gjithashtu, Edi Rama shtoi se vendosi ta merrte vetë postin e min-

Mosdekretimi, Rama: Kemi bërë gati disa padi kundër Presidentit Meta



istrit të Jashtëm, pasi nuk donte që të emërohej një ministër tjetër në një kohë kaq të shkurtër. "Votimi i sotëm ishte rezultat e një zgjedhjeje të detyruar. Pasoje e mos-

dekretimit të presidentit. Dua ta bëj të qartë për opinionin publik: Në kushtet kur nuk kemi Gjykatë Kushtetuese dhe në pritje të formimit të saj, për të

gjujkar nga ana e saj vendimin e presidentit vendosa të marr unë këtë post. Nuk doja që të zgjidhej një ministër i ri për një periudhë të shkurtër", - u shpreh kryeministri ndër të tjera. Por pavarësisht kësaj deklarate, kryeministri që të marrë detyrën e tij si ministër i Jashtëm duhet të ballafaqohet edhe një herë me Presidentin Meta kur të bëjë betimin. Por për të kryer këtë akt formal, Rama duhet të presë, pasi Presidenti i Republikës nuk ndodhet në Shqipëri. Ai po zhvillon një vizitë disaditore në Mal të Zi dhe sipas burimeve, ai mund të kthehet nesër. Deri atëherë Rama nuk mund të marrë dot detyrën si ministër.

Basha: Rama si Enver Hoxha, ministrat e rinj janë kukulla anonimë

Kryeministri Edi Rama është votuar mbremë edhe si ministër i Jashtëm, ndërsa sot pritet që të shkojë në Presidencë për t'u betuar para Presidentit Ilir Meta. Kuvendi në seancën e parë të këtij sesiioni parlamentar votoi me 78 vota pro dekretin për emërimin e Ramës si ministër të Jashtëm, ndërsa më parë kishte shkarkuar nga ky post me 77 vota pro dhe 1 abstenim (Spartak Braho) Ditmir Bushatin. Ky votim i hap rrugë tashmë edhe procedurës formale të betimit para presidentit, para se Rama të marrë zyrarisht edhe detyrën e ministrit. Ndërkohë që përveç këtij votimi, Kuvendi u përfshi në një sërë deklaratash të ashpra të krerëve të opozitës dhe kryeministrit Edi Rama, çka paralajmëron një sesion të tensionuar politikë dhe parlamentar.

Rama votohet edhe si ministër i Jashtëm, shkarkohet Bushati

Kryemadhi: Integrimi kërkon dialog politik



zim Basha, i cili ironizoi ministrat e rinj, duke i cilësuar kukulla të kryeministrit dhe që nuk përfaqësojnë asgjë. "A e njihni kush është kjo zonjë, a i njihni kush janë, çfarë janë? Më thonë: A i mbani mend emrat, ministere e kujt është kjo. Mos pëllit. Anëtarë të PS-së, a iu përfaqësojnë ju, apo kontot bankare të oligarkësh? Ata ia kanë sjellë. Pazaret e milionave", - u shpreh Basha. Më tej, ai sulmoi ashpër kryeministrin, i cili sipas tij teksa u përpoq të imitojë Ismail Qemalin dhe Hasan Prishtinën, por i ra fasada dhe u bë si Enver Hoxha. Vendi sot është në emergjencë kombëtare", - tha Basha, ndërsa me përfundimin e fjalës së tij opozita u largua nga salla.

është injoranca e një të cmenduri. Vendi është në duar e një të marri, i dalë binarësh, pasi ka shkatërruar thelbin e demokracisë atë të ndarjes së pushteteve. Bëri sikur imitoi Ismail Qemali dhe Hasan Prishtinën, por i ra fasada dhe u bë si Enver Hoxha. Vendi sot është në emergjencë kombëtare", - tha Basha, ndërsa me përfundimin e fjalës së tij opozita u largua nga salla.

RAMA

Në emër të mazhorancës, kryeministri Rama mbrojti ndryshimet në qeverinë dhe ministrat e rinj, të cilët sipas tij përfaqësojnë më së miri filozofinë e PS-së për t'u vetëkorriguar dhe rifreskuar me elementë të

rinj. "Nuk kanë, të paktën për disa kohë, mundësi që të hedhin baltë. Zero! Sepse kush është bashkuar me ne në qeveri duke ardhur nga të tjera drejtime ka një karrierë profesionale dhe ka një integritet të padiskutueshëm dhe mishëron atë që jemi ne, atë që PS ka qenë kohë më parë dhe atë që e ka bërë PS-në thelbësisht të ndryshme nga këto partitë e tjera dhe që ka mundësiar ripërtëritjen e vazhdueshme të saj", - u shpreh kryeministri. Ndërsa theksoi se protesta e studentëve i dha mundësi PS-së të ndryshojë, ai u shpreh se ajo nxori në pah se opozita nuk është fare një alternativë. Duke u ndalur te ngjarja e 21 janarit, kreu i qeverisë u shpreh se ajo ngjarje mbetet ende një plagë e hapur. "Ende ata që janë përgjegjës janë të pandëshkuar. Por është e vërtetë që sot Shqipëria nuk është ajo që ishte vjetër dhe është e vërtetë që gjyqtarët e 21 janarit janë sot rrugëve, nesër mund të përfundojnë pas hekurave. Natyrisht që askush kush nga ne nuk do të donte që kjo çështje të ishte mbyllur dhe ndoshta ndokush këtu të ishte prapa hekurave për atë që ndodhi në bulevard. Por, ne nuk jemi uzurpatorë të pushteteve", - u shpreh kryeministri.

MINISTRAT

"A e njihni kush është kjo zonjë, a i njihni kush janë, çfarë janë? Më thonë: A i mbani mend emrat, ministere e kujt është kjo. Anëtarë të PS-së, a iu përfaqësojnë ju, apo kontot bankare të oligarkësh? Ata ia kanë sjellë. Pazaret e milionave", - u shpreh Basha.

SHKURTE

PS pranon kërkesën e opozitës, shtyhet reforma zgjedhore me 1 muaj

Ndonëse mandati i Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore ka mbaruar që në fund të dhjetorit, Kuvendi ka votuar dje për shtyrjen e afatit të tij edhe me 1 muaj tjetër. Kjo, me qëllim që t'u japë mundësi forcave politike parlamentare që të miratojnë ndryshimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor. Ndërkohë që gjatë seancës së djeshme, mazhoranca ka bërë edhe zëvendësimet në kryesitë e komisioneve të përhershme parlamentare që lindën si nevojë, pasi drejtuesit e mëparshëm u bënë ministra. Kështu, Arben Ahmetaj do drejtojë komisionin e Ekonomisë dhe Financave duke zëvendësuar Erion Braçen, Niko Peleshin do drejtojë Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese duke zëvendësuar Eduard Shalshin, ndërsa Senida Mesi do jetë nënkryetare e Komisioni i Integritetit dhe Klodiana Spahiu nënkryetare të Komisioni i Shëndetësisë.

Kryeministri: Infrastruktura e universiteteve do bëhet me PPP

Nga foltoja e Kuvendit, kryeministri Edi Rama ka folur edhe mbi anulimin e marrëveshjes për projektin e rrugës Thumanë-Kashar-Rrogovinë. Sipas tij, anulimi i këtij projekti nuk do të thotë që qeveria do marrë lekë që kishte përcaktuar për këtë rrugë dhe për t'i kaluar te Pakti për Universitetin, por që marrëveshjen me sektorin privat ta përdorë për të ndërtuar infrastrukturën universitare. "Kjo nuk do të thotë që paratë janë në buxhet sot. Këto do të bëhen bashkë dhe do të jenë një program për infrastrukturën e universiteteve, përfshi kampusin dhe elementët të tjerë në universitete të tjera, të cilin ne do ta ofrojmë për bashkëpunim me sipërmarrjen, paqetë Partneritet Publik-Privat, por jo më për të bërë aksin Thumanë-Kashar, por për të transformuar përgjithmonë gjithë infrastrukturën e universitetit", - tha Rama.

AKUZAT POLITIKE VENDIMI

Gjyba do paguhet brenda 6 muajsh, Balla: Historike. PD: Gjykata, nën presionin e vetingut

Gjykata dënon Bashën me 50 mijë lekë gjobë për shpifje

"Balla porositi një 'Toyota Yaris' me 3.4 mil euro"

Valentina Madani

Gjykata Penale e Tiranës shpalli dje fajtor kryetarin e PD-së Lulzim Basha për akuzën e shpifjes së kryer botërisht në dëm të viktimës akuzuese, Taulant Balla. Ai u dënua me 50 mijë lekë gjobë. Basha akuzoi kreun e deputetëve socialistë, Taulant Balla në seancën plenare të 25 qershorit se ai ishte garantuesi i hyrjes në Shqipëri të 3.4 milionë eurove të sekuestruara në portin e Durrësit. Sipas Bashës sasia e parave i përkiste një ndër grupeve më të rrezikshme të trafikut të drogës në Elbasan. Por kjo akuzë e penalizoi dje me gjobë të cilën do ta paguajë brenda një afati 6 mujor, nga dita që ky vendim merr formë të prerë. Po kështu Basha do të paguajë edhe shpenzimet e gjyqit. "Gjykata arrin në përfundim se deklaratat e bëra botërisht të akuzuarit Basha kanë qartësisht natyrë shpifëse ndaj viktimës Taulant Balla. Për pasojë gjykata e çmon se me veprimet e mësipërme i akuzuari Lulzim Basha ka konsumuar plotësisht elementët e kundërvajtjes penale të "shpifjes" të kryer botërisht parashikuar nga neni 120/2 e KP në dëm të viktimës akuzuese Taulant Balla. Rrjedhimisht Lulzim Basha duhet të shpallet fajtor për këtë veprë penale" thuhet në vendim. Kundër këtij vendimi mund të ankimohet brenda 15 ditëve nga dita e shpalljes së vendimit, 21 janar 2019.

REAGIMET

Vetë Balla e quajti "vendim historik" ndërkohë që parajamëroi kreun e PD-së se do të përballet dhe me një padi tjetër, këtë herë civile. "Është një vendim historik për të cilin ne politikanët duhet të reflektojmë gjatë, i pari që duhet të reflektojë është Lulzim Basha që sot është shpallur fajtor penalisht dhe i detyrohet shtetit shqiptar të shlyejë dënimin e merituar që gjykata dha. Së dyti, i kërkoj Lulzim Bashës dhe PD të heqin dorë nga kjo politikë bajate e bazuar tërësisht në shpifje. Në aspektin civil e njoftoj Bashën sot se do të përballet dhe me një



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

AKUZA

Kreu i PD-së, Lulzim Basha akuzoi kreun e grupit parlamentar të socialistëve, Taulant Balla në seancën plenare të 25 qershorit se ai ishte garantuesi i hyrjes në Shqipëri të 3.4 milionë eurove të sekuestruara në portin e Durrësit.

Salianji dorëhiqet nga postet në PD: Standard për ata që s'përmbyshin objektivat

Ervin Salianji dorëhiqet nga posti i sekretarit të grupit parlamentar të PD-së pak ditë pasi mbeti jashtë kryesisë së PD-së. Nga viti 2016 Ervin Salianji mbante detyrën e sekretarit për aksion qytetar në PD, por ky pozicion u shkri me vendim të kreut të PD-së. Salianji thumboi me anë të një statusi në 'Facebook' duke thënë që "numërimi" e la jashtë me një votë ndaj kjo matematikë duhet lexuar me përgjegjësinë e duhur. "Numërimi për kryesinë më nxori jofitues me 1 votë, kjo matematikë duhet lexuar me përgjegjësinë e duhur. Ndaj duhet marrë koha e nevojshme për të vendosur se çfarë duhet të bëjë më shumë për të merituar besimin, për të luftuar me qeverinë, apo të bëjë opozitë më të fortë për të qenë përfaqësues i demokratëve për një fitore edhe në numra edhe në



frymë. Gjykoj që çdo herë verdikti duhet lexuar qartë dhe duhen mbajtur përgjegjësi, mendoj që politika dhe Partia Demokratike ka nevojë për vendosjen e një standardi përgjegjësie, ku secili sipas funksionit mban përgjegjësi! Gjykoj që dorëheqja shumë shpesh e munguar në politikë duhet të kthehet standard! Funksioni im politik si sekretar i grupit parlamentar të Partisë Demokratike i takon të zgjidhet nga kryesia e re, për

padi tjetër", tha z.Basha. Përfaqësuesi ligjor i Bashës, Gazmend Bardhi teksa parajamëroi apelimin e vendimit tha se togat e zeza janë nën presionin e vetingut. "Gjykata në presion për vetingun. Ky është një vendim qesharak. Për gjykatën këtu ka rëndësi çfarë thotë Taulant Balla dhe policia e inkriminuar. Barrën e

provës kjo gjykatë qesharake ia kaloi Lulzim Bashës. Vendimi asgjësoi organin e prokurorisë. Vendimi shprehet qartë. Poli Policia e Shtetit, Taulant Balla nuk ka lidhje me këtë çështje, sepse kështu ka thënë Policia e Shtetit e Taulant Ballës, ndërkohë që prokuroria e ka në proces hetimi. Nuk ka persona të deklaruar fajtorë

ZËVENDËSIMI

Në votimin e KK-së, kreu i komisionit zgjedhor në PD, Jemin Gjana, tha se nxjerrja nga lista fituese e Salianjit dhe disa deputetëve të tjerë demokratë u bë për shkak të respektimit të kuotave gjinore.

këtë arsye jap dorëheqjen! Kjo me jep më shumë mundësi të takoj dhe dëgjoj demokratët për t'u përgatitur, dhe për të bërë fushatë për të rifituar besimin e organeve të larta të partisë!", shprehet z.Salianji. Ai shkruan më tej se dorëheqja pas çdo rezultati duhet të kthehet në standard në politikë për çdo mosarritje, gjithashtu, ai shkon se nga nesër do vijojë të jetë në krah të protestave.

mbi këtë çështje, sepse hetimet vijojnë ende. Nëse jemi kthyer në sistemin ku policia përcakton se kush është i fajshëm dhe kush i pafajshëm, kush është i përfshirë në trafik drogë dhe kush jo, cila është lidhja e Taulant Ballës me 3.4 milionë euro, atëherë jemi kthyer zyrtarisht në diktaturë", tha z.Bardhi.



Presidenti Ilir Meta gjatë takimit të djeshëm me homologun e tij, Milo Gjukanoviq

Protestat, sot mblidhet Kolegji i Kryetarëve të PD

Demokratët nga dita e sotme do të zbrisin në terren për përgatitjet e protestave masive kundër qeverisë "Rama". Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha zhvilloi dje mbledhjen e parë me sekretarët e sapo zgjedhur të selisë blu. Në këtë takim mori pjesë dhe ish-presidenti Bujar Nishani tashmë në detyrën e kryetarit të Këshillit Kombëtar. Mësohet se Basha u ka kërkuar të përqendrojnë punën të organizimi i protestave, duke ua përcaktuar dhe si detyrë kryesore. Opozita e bashkuar ka njoftuar fillimin e protestave, të cilat nuk do të ndalen deri në rrëzimin e qeverisë 'Rama' dhe krijimin e një qeverie tranzitore, e cila do të çojë vendin drejt zgjedhjeve të lira dhe të barabarta. Kryesia e PD-së, që doli nga votimi i së premtes, zhvilloi mbrëmë mbledhjen e konstituimit. Sekretari i përgjithshëm i Partisë Demokratike Gazmend Bardhi, u shpreh se gjatë mbledhjes u diskutua lidhur me protestat që do të organizojë opozita. Bardhi tha se ditën e sotme do të mblidhet Kolegji i Kryetarëve në PD për këtë çështje e më pas edhe kryesia, për të vendosur se kur do nisnin protestat dhe si do zhvillohen. "Në zbatim të vendimit të Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike që ngarkoi kryesinë e re me organizimin e protestave popullore me qëllim largimin e qeverisë së Edi Ramës, kryesia ka diskutuar mbi strategjinë e protestave që do ndjekë PD dhe opozita për realizimin e kësaj vendimmarrje të Këshillit Kombëtar. Vendimi i kryesisë së PD-së është që nesër (sot) në orën 11:00 të thërrasë mbledhjen e Kolegjit të Kryetarëve, një organ i ri statusor i PD-së për të diskutuar paraprakisht me ta mbi strategjinë e protestave që duhet të ndiqen dhe më pas gjatë pasdites do ketë një mbledhje tjetër të kryesisë së PD-së mbi detajet dhe strategjinë e protestave që do ndjekë opozita. Ky ishte vendimi i kryesisë, nesër në 11 do të mblidhet kolegji i kryetarëve që do diskutojë formën e protestës, datën e protestës dhe detaje që lidhen me protestën dhe me zbatimin e vendimit të këshillit kombëtar", tha Gazmend Bardhi.

NJOFTIM

Në datë 05.02.2019 në orën 16.00 në zyrën e përbaruesit gjyqësor privat Irina Tereziu PF me adresë në "Rruga Fadli Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njësia Tregtare nr.10, Tiranë", zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Trruall-Ndertesë" me sip. Trruall 220 m2 dhe sip.ndertesë 97 m2, me nr.pasune 11/23, volum 10, faqe 229, zone kadastrale 8503, ndodhur në Lagja "Jani Vruho", BeraCimni ne ankand te dyte eshte ne vleren 2,296,000 (dy milion e dyqind e nentehjete e gjashte mije) lekë.



Valentina Madani

Ish-kreu i Shërbimit Informativ Shtetëror, Bahri Shaqiri, i cili aktualisht mban detyrën e Këshilltarit të Presidentit për Çështjet e Sigurisë Kombëtare u propozua dje nga presidenti Meta për të drejtuar Kontrollin e Lartë të Shtetit. Në propozimin drejtuar Kuvendit, Meta argumenton se Shaqiri ka integritet të lartë dhe plotëson të gjitha kriteret ligjore për t'u emëruar në këtë pozicion. "Z.Shaqiri është një kandidat me eksperiencë në drejtimin e institucioneve dhe ka njohuritë e duhura në fushën e ligjit dhe auditimit. Gjatë ushtrimit të detyrave Shaqiri ka patur bashkëpunim të shkëlqyer me partnerët ndërkombëtarë, në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe atij ekonomiko-financiar", shprehet kreu i shtetit. Gjatë ushtrimit të detyrave të mësipërme, vijon presidenca - ka patur bashkëpunim të shkëlqyer me partnerët ndërkombëtarë, në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomiko-financiar si dhe ka njohuritë e duhura në fushën e ligjit dhe auditimit për të garantuar drejtimin profesional të këtij institucioni të paruar. Dekreti nr 11063, datë 19.01.2019 dhe dokumentacioni shoqëruar në kësaj kandidaturë iu përcoll sipas ligjit Kuvendit të Shqipërisë për miratim. Bahri Shaqiri ka një eksperiencë 26-vjeçare në institucionet e larta shtetërore si: Ministria e Financave, Shërbimi Informativ i Shtetit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturas. Tashmë pritet që Kuvendi të shqyrtojë këtë kandidaturë të propozuar nga Presidenti. Një muaj pasi Kuvendi i rrëzoi propozimin e Vitore Tushës, presidenti Ilir Meta u detyrua të përzgjedhë një tjetër kandidat për postin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Bahri Shaqiri, ish-drejtor i shërbimit Informativ Shtetëror dhe aktualisht këshilltar i Presidentit për Çështjet e Sigurisë Kombëtare është kandidatura e propozuar nga kreu i shtetit, për të marrë drejtimin e KLSH-së. Emri i ish-kryetarit të SHISH është propozimi i dytë i presidentit për postin e kreut të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Emri i parë që u qua Kuvendit ishte ai i Vitore Tushës, i cili u hodh poshtë nga shumica në Kuvend, për shkak të zgjedhjes së saj si anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

DEKRETI



Manjani: Paska marrë vullën e Presidencës me vete

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani reagoi jo pa ironi, dje pas lajmit të Presidencës, për dekretin e Presidentit Ilir Meta drejtuar Kuvendit, lidhur me propozimin e Bahri Shaqirit për kreu e KLSH-së. Me një shënim në faqen e tij në "Facebook", Manjani shprehet se dekreti vjen në kohën që kreu i shtetit ndodhet për vizitë në Malin e Zi. "Presidenti, nga Mali i Zi ka lëshuar një dekret, për kryetarin e KLSH. Paska marrë vullën e Presidencës me vete", shprehet ish-ministri i Drejtësisë Ylli Manjani.

Presidenti: Shaqiri ka integritet të lartë dhe plotëson të gjitha kriteret ligjore

Meta propozon Shaqirin për KLSH, PS paralajmëron rrëzimin

Manja: Nuk ka ekspertizë në fushën e financave

ULSI MANJA

"Kandidatura e Bahri Shaqirit për KLSH, përveçse është një kandidaturë me profil të lartë politik pasi vjen nga forumet drejtuese të LSI, ka edhe një problem serioz kushtetues. Kushtetuta e përcakton qartë si kriter të kandidatit për kreun e KLSH, ekspertizën në fushën e financave".



Ish-kreu i Shërbimit Informativ Shtetëror, Bahri Shaqiri

ILIR META

"Z.Shaqiri është një kandidat me eksperiencë në drejtimin e institucioneve dhe ka njohuritë e duhura në fushën e ligjit dhe auditimit. Gjatë ushtrimit të detyrave Shaqiri ka patur bashkëpunim të shkëlqyer me partnerët ndërkombëtarë, në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe atij ekonomiko-financiar", shprehet kreu i shtetit.

Vizita, Podgorica mbushet me flamuj kuqezi

Meta takon Gjukanoviç: Integrim më të plotë të shqiptarëve të Malit të Zi



Presidenti Ilir Meta nisi dje vizitën e tij në Malin e Zi me një takim me homologun e tij Milo Gjukanoviç. Duke folur pas takimit në konferencën e përbashkët, Presidenti Meta nënvizoi se forcimi edhe më shumë i marrëdhënieve dypalëshe, integrimi edhe më i plotë i shqiptarëve të Malit të Zi, si dhe kursi evropian dhe euro-atlantik i rajonit, është në interesin më të mirë të përbashkët të dy vendeve. "Një temë mjaft e rëndësishme e forcimit të bashkëpunimit tonë ka të bëjë edhe ajo me integrimin e mëtejshëm të shqiptarëve në Malin e Zi dhe po kështu me respektimin e të drejtave të pakicës malazeze në vendin tonë. Jam krenar për përkushtimin e shqiptarëve këtu në Malin e Zi, që nga parvarësia, që nga shtet-

formimi dhe në vijimësi për të gjithë mbështetjen e palëkundur që i kanë dhënë forcimit të shtetit të Malit të Zi dhe integritetit të tij euro-atlantik dhe në Bashkimin Evropian. Sepse në këtë mënyrë i kanë shërbyer interesit më të lartë, jo vetëm të Malit të Zi, por në

këtë mënyrë i kanë shërbyer edhe forcimit të paqes, të sigurisë dhe të stabilitetit në rajonin tonë", tha z.Meta. Presidenti u shpreh më tej se: "gjeta te Presidenti Gjukanoviç mirëkuptim dhe angazhim për një përkujdesje edhe më të madhe ndaj të drejtave të

shqiptarëve, për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës, traditave dhe identitetit të tyre, për përfaqësimin më përfshirës në nivel qendror dhe lokal, për nxitjen e investimeve dhe zhvillimin ekonomik të zonave ku ata jetojnë, për mbështetjen e një integrimi më të mirë të tyre këtu në Malin e Zi". Gjatë kësaj vizite, veç takimeve me krerët e lartë të Malit të Zi, Presidenti Meta do të takohet dhe me përfaqësuesit e partive shqiptare në Mal të Zi si dhe do të vizitojë qytetet e Tuzit, Tivarit dhe Ulqinit. Rrugët e Podgoricës, si asnjëherë më parë, janë veshur me flamujt kuqezi në nder të Presidentit të Shqipërisë.

MASHORANCA

Deputeti i Partisë Socialiste, Ulsi Manja e cilësoi si të pamundur propozimin e Presidentit Ilir Meta, lidhur me kandidaturën e Bahri Shaqirit për kreun e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në një reagim në rrjetet sociale, të cilin e quan opinion personal, kreu i Komisionit të Ligjeve Ulsi Manja shkruan se kandidatura e Shaqirit për Kontrollin e Lartë të

Shtetit, përveçse është një kandidaturë me profil të lartë politik, pasi vjen nga forumet drejtuese të LSI, ka edhe një problem serioz kushtetues. Kreu i Komisionit të Ligjeve Ulsi Manja shkruan se kandidatura e Shaqirit, këshilltarit të presidentit, nuk plotëson kriterin bazë, atë të ekspertizës në fushën e financave. "Kandidatura e Bahri Shaqirit për Kontrollin e Lartë të Shtetit,

përveçse është një kandidaturë me profil të lartë politik pasi vjen nga forumet drejtuese të LSI, ka edhe një problem serioz kushtetues. Kushtetuta e përcakton qartë si kriter të kandidatit për drejtimin e KLSH, ekspertizën në fushën e financave. Mbese zoti Shaqiri ka punuar me financat e LSI dhe këtë mund të ketë pasur parasysh kryetari në distancë i LSI, Presidenti Meta, kur e

ka propozuar. Për sa i takon Komisionit të Ligjeve e shoh realisht të pamundur dritën jeshile për z.Shaqiri. Për të cilin kam respekt për si e ka drejtuar SHISH-in, në kohën kur qeverisnin z. Berisha bashkë me z.Meta", shprehet z.Manja. Neni 20 i ligjit për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit përcakton edhe kushtet për t'u zgjedhur në krye të këtij institucioni.

TIRANË - Gjykata e Tiranës ka dënua dje me 50 mijë lekë gjobë për shpifje ish-juristin Romeo Kara, i cili akuzoi djalin e ish-kryeministrit shqiptar, Shkëlzen Berisha se në bashkëpunim me një person tjetër ka luajtur rolin e sekserit në privatizimin e kompanisë OSSH të çekët e CEZ-it. "Deklarimin fajtor të të akuzuarit z. Romeo Kara, për kryerjen e veprës penale të "Shpifjes", së kryer botërisht në dëm të vik-



Ish-juristi i CEZ, Romeo Kara

Shpifi ndaj Shkëlzen Berishës, gjykata dënua me 50 mijë lekë gjobë ish-juristin e CEZ, Romeo Kara

timës akuzues z. Shkëlzen Berisha, parashikuar nga neni 120/2 i K.Penal dhe në bazë të këtij neni, dënimin e të akuzuarit me 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë gjobë. Në aplikim të nenit 34 të KP, i akuzuari Romeo Kara do ta paguajë këtë gjobë brenda një afati prej 6 (muajsh), nga dita që ky vendim do të

marrë formë të prerë. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga e nesër mja e shpalljes së tij, në Gjykatën e Apelit Tiranë", thuhet në vendimin e gjykatës. Kjo nuk është hera e parë që Kara dënohet për shpifje ndaj Shkëlzen Berishës. Më 15 nëntor të vitit të kaluar

gjykata e kryeqytetit e shpalli fajtor për shpifje ish-juristin e CEZ dhe e dënua me 500 mijë lekë të vjetra për deklarimet e bërë në "Facebook" në vitin 2017, ku shkruante se djali i ish-kryeministrit Sali Berisha ka bërë trafik droge. Ai është dënua me gjobë për veprën penale "Shpifje e kry-

er botërisht". Por, vetë Kara ka deklaruar se e kishte huazuar akuzën nga një intervistë televizive e Izet Haxhiajt në vitin 2014. Izet Haxhia e akuzonte Shkëlzen Berishën se ishte përfshirë në trafik droge. Por, Shkëlzen Berisha u kundërpërgjigj dhe e përgjeshitroi Haxhiajt dhe tha se nuk mund të çonte në gjyq një vrasës. Të njëjtat akuzat i ka përmendur Kara, të cilin Shkëlzen Berisha e ka akuzuar për shpifje.

Prokuroria: Hekuran Hoxha, porositi të drogës në Brenog të Hasit

Trafiku i heroinës, Krimet e Rënda lënë në burg "Ronin e Shijakut"

48-vjeçari vuan nga zemra, masa e sigurisë iu dha në QSUT

TIRANË

Hekuran Hoxha, i cili dyshohet të jetë koka e grupit "Avdyllaj" që u godit në muajin tetor të vitit që shkoi në kuadër të operacionit të koduar "Volvo 4" është lënë dje në burg nga Gjykata e Krimet të Rënda. 48-vjeçari, i njohur ndryshe dhe si "Ronin e Shijakut" iu komunikua masa e sigurisë në repartin e kardiologjisë, në QSUT në Tiranë ku ndodhet nën kujdesin e mjekëve. Mësohet se pas arrestimit mbremjen e së premtes, Hoxha ka pësuar përkëqesim të gjendjes shëndetësore (ka probleme me zemrën) dhe për pasojë ka përfunduar në spital. Dy prokurorë, një gjyqtar, një avokat dhe disa policë ishin në spital në repartin e kardiologjisë. Ndërkaq, jashtë ambienteve të QSUT-së, avokati i tij deklaroi për mediat lidhjen që klienti i tij ka me Admir Hoxhën, njeriu që ka iniciuar ngritjen e laboratorit në Has. Ai u shpreh se Hoxha nuk ka asnjë lidhje familjare me klientin e tij, por ai ka qenë i punësuar para 10 vitesh në biznesin e tij. Sipas avokatit, gjendja shëndetësore e klientit të tij është e rëndë dhe pritet të nënshtrohet një ndërhyrjeje të tretë pas dy të tillave që ka bërë në vitin 2013. "Për këtë arsye, gjykata dhe prokuroria vendosën që ta bënin këtë procesin



48-vjeçari i arrestuar, Hekuran Hoxha

gjyqësor për masën e sigurisë. Gjykata u tregua e ashpër me vendimin që dha, duke qenë se ishimi para kushteve ndaluese. Nuk ka asnjë provë konkrete që klienti im është i lidhur me ve-

primtaritë kriminale", u shpreh avokati. Hekuran Hoxha akuzohet për katër vepra penale dhe konkretisht "Prodhim dhe shitje e narkotikëve", "Trafikimi i narkotikëve", "Prodhim dhe

AKUZAT

Sipas hetuesve të çështjes, Hekuran Hoxha dyshohet për kryerjen e veprave penale "Prodhim dhe shitje e narkotikëve", "Trafikimi i narkotikëve", "Prodhim dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope, në bashkëpunim me formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal", "Grup i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal" si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale".

fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope, në bashkëpunim me formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal", "Grup i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale

nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal" si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale". Një ditë pas vënies së tij në pranga, burime pranë grupit hetimor bënë me dije se dyshohet që 48-vjeçari ishte personi që luante rolin kryesor në trafikimin heroinës që prodhohet në laboratorin e Hasit. Sipas prokurorisë, Saimir Gjepali (i shpallur në kërkim) dhe Hekuran Hoxha janë dy kontaktet e biznesmenit Admir Hoxha, që akuzohet si njeriu që financoi drogën e laboratorit të drogës të forta. Biznesmeni vazhdon ende të jetë në kërkim nga policia, së bashku me dy shtetas turq dhe një kosovar që punonin për prodhimin e heroinës në laborator. Po të njëjtat burime thanë se Hoxha dyshohet se drejtonte trafikun e drogës nga Shqipëria drejt vendeve të tjera të Europës.



Shtyhet gjyqi për Emiljano Shullazini dhe bandën e tij

TIRANË - Gjykata e Apelit të Krimet të Rënda dje ka shtyrë seancën e parë gjyqësore për Emiljano Shullazini dhe bandën e tij. Mësohet se shkak i kësaj shtyrjeje është bërë kërkesa e avokatit të Blerim Shullazit, Bledar Meminaj, i cili ka kërkuar më shumë kohë që të njëjti me dosjen. Kjo për shkak se më herët avokat ka qenë Aldo Tabaku. Ndërkaq, seanca e radhës do të zhvillohet më datë 4 shkurt, ora 9:30. Një muaj më parë, Krimet e Rënda dënua me 55 vite burg në total Emiljano Shullazini, Gilmandan Danin, Endrit Qyqjen, Endit Zelën si dhe Blerim Shullazini. Për Shullazini u dha 14 vite burg, ndërsa ai bashkë me bandën e tij akuzohen për krijim të grupit të strukturuar kriminal, gjëbënie dhe kanosje për shkak të detyrës.

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në kuadër të projektit "Improving awareness and prevention of thalassemia and other haemoglobin disorders (AWAPRE-globin); projekt pilot në Shqipëri" Ref.No. IADSA/2017/15,

Bashkia Divjakë është në kërkim të dy figurave profesionale në fushën shëndetësore:

1. BIOLOG
2. INFERMIER

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë në profilin: Infermier i Përgjithshëm dhe Biologji Molekulare
2. Të ketë eksperiencën që lidhen me fushën e projektit.
3. Të zotërojnë një gjuhë të huaj
4. Të ketë aftësi komunikuese dhe të punuarit në grup
5. Të mos jetë i dënua me vendim të formës së prerë nga gjykata

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë **Sektorit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Divjakë** dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim
2. Curriculum Vitae
3. Kopje të diplomës dhe të listës së notave (të notuara)
4. Raport mjekësor për aftësitë në punë
5. Dëshmi penaliteti

Dokumentat pranohen deri më datë **05.02.2019**

Lëvizjet e ministrit Sandër Lleshaj, emërohet në krye të SHÇBA Muhamet Rrumbullaku

TIRANË - Të tjera lëvizje janë bërë nga ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj. Ditën e djeshme, ai ka firmosur emërimin e drejtuesit të ri të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA). Në vendin e Anila Trimit që u emërua nga Fatmir Xhafaj kur ishte në postin e ministrit, do të jetë Muhamet Rrumbullaku, një drejtues me eksperiencë të gjatë në Policinë e Shtetit. Lajmi u bë me dije nga zëvendësministri i Brendshëm, Besfort Lamallari, gjatë një takimi me drejtuesit qendrorë të SHÇBA. "Rrumbullaku, drejtues me përvojë në Policinë e Shtetit, i larguar 5 vitet e fundit, do të marrë



Ministri Sandër Lleshaj

drejtimin e institucionit që ka si detyrë funksionale kontrollin e ligshmërisë së punës së organizatës së policisë. Ai mban gradën Drejtues i Parë, ka një eksperiencë të gjatë në Policinë e Shtetit dhe për shumë vite ka qenë zv.drejtori i Përgjithshëm i Policisë për Rëndin dhe

Sigurinë Publike (2009-2013), ndërsa më parë ka qenë drejtor i Policisë së Tiranës dhe në disa qarqe të tjera, tha Lamallari. Gjatë qeverisjes teknike të vitit 2017, Rrumbullaku u emërua për disa muaj këshilltar i ministrit të Brendshëm, Dritan Demiraj.

"I vendosi 2 kushte policisë: Të mos dhunohej dhe arrestimin të mos e shisnin si meritë"

Mediat italiane: Ja tri arsytet që çuan në vetëdorëzimin e Klement Balilit

"Tonelatat me marijuanë që u sekuestruan në Greqi kishin destinacion Milanon"

ITALI

Pak ditë pas vetëdorëzimit të Klement Balilit, i ashtuquajtur si "Eskobari i Ballkanit", ngjarje kjo e bujshme e fillimit është pasqyruar me detaje edhe në mediat italiane, të cilat përshkruajnë aktivitetin e 48-vjeçarit. Mes tjerash, ata theksojnë se emri i Balilit është publikuar nga mediat greke dhe ai shfaqet si i implikuar në trafikun e marijuanës, e kapur në Greqi në sasi mbi 700 kg. Sipas medias "Milano Today", e cila citon burime të "Corriere", shkruan se droga e sekuestruar nga policia greke kishte si destinacion tregun në Milano të Italisë. Gjithashtu, në raportin e publikuar dje nga media e shtetit fqinj përshkruhen me detaje të gjitha të dhënat e Balilit dhe postet që ka mbajtur në Sarandë. Klement Balili u vetëdorëzua në Policinë e Shtetit të martën e kaluar, ndërsa ky veprim mori jehonë jo vetëm në mediat shqiptare, por edhe më gjerë. Sipas "Milano Today", policia shqiptare ka negociuar për tre muaj radhazi me familjarët e Klement Balilit për t'u dorëzuar. Fjalët e ish-ambasadorit amerikan, Donald Lu, i cili e quante Balilin si "Peshku i madh" kanë gjetur pasqyrim të detajuar edhe në shtypin italian. Ndërkaq, në artikullin e publikuar nga gazeta "Corriere Della Sera" citohet se Balili u dorëzua në polici me dy kushte, që të mos dhunohej gjatë transferimit në burg dhe policia të mos e shiste arrestimin si meritë.

SHKRIMI I "CORRIERE DELLA SERA"

Ata e quajnë "Balkan Escobar", me këtë pseudonim që vjen nga jashtë vendit. Në këtë rast, Klement Balili është quajtur kështu për aftësinë për të qenë tregtar droge dhe njëkohësisht edhe një sipërmarrës kriminal me lidhje të rënda mes institucioneve. Balili, 48 vjeç, u dorëzua në Delvinë, në jug të Shqipërisë, drejtpërdrejt të shefi i policisë Ardi Veliu, pas tre muajsh bisedime. Ai u dorëzua me dy kushte: asnjë dhunë gjatë transferimit në burg dhe policia të mos e shiste arrestimin si meritë. Megjithatë në fund, e tillë ishte. Por pjesa më interesante fillon tani. Balili ishte një drejtor i rëndësishëm shëtitëror, gjithashtu një mbajtës sekretesh.

RRUGËT

"Corriere" është njohur me Balilin në vitin 2016, pas konfiskimit në Greqi të një sasive të madhe marijuane. Sipas Guardia di Finanza, që kishte marrë pjesë në këtë

Sulle rotte della marijuana: l'«Escobar dei Balcani» si consegna agli investigatori

In cella l'albanese 48enne Klement Balili. Fra i suoi segreti gli equilibri cittadini. Si è arreso a i due condizioni: nessuna violenza durante il trasferimento in prigione e la promessa della polizia di non venderli l'arresto.

di Andrea Galli

Faksimile e mediave italiane



Klement Balili në gjykatë

AKUZAT NDAJ BALILIT

Klement Balili u dorëzua mëngjesin e së martës pas 3 muaj negociatash mes drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Ardi Veliu dhe nipit të tij, Rigers Balili, me detyrë kryetar i Bashkisë së Delvinës. Por, pavarësisht vetëdorëzimit edhe në prani të njërit prej familjarëve të tij, policia pretendon se 46-vjeçari nuk e përballoi dot presionin dhe rrethimin policor, të paktën gjatë dy muajve të fundit. 46-vjeçari akuzohet për "Trafik ndërkombëtar lëndësh narkotike, në bashkëpunim", "Pjesëmarrje në grupin e strukturuar kriminal", "Refuzim për deklarim, mosdeklarim, fshehje ose deklarim i rremë i pasurive", si dhe për "Pastrim parash".

operacion dhe kishte hetuar se kush e kishte ngarkesën, ishte e destinuar për në Milano. Hetuesit ishin të sigurt se e dinin se pas atyre kuintalëve ishte ai, Balili, i arratisur në Greqi. Ai ka një listë me apartamente të përdorura si baza dhe depozita për të fshehur drogën.

ARSYET E DORËZIMIT

Një ekspert i drogës dhe analist i skenarëve ndërkontinentalë dhe gjithmonë në fuqi të Guardia di Finanza, sugjeron këtë zgjidhje: Kush i dorëzohet policisë, e bën për dy ose tri motive: nga frika se mos e vrasin e është i detyruar të kërkojë ndihmën e policisë; sepse i janë shkatërruar të gjitha mbrojtjet që ka pasur deri në atë moment, mbrojtje institucionale, nga kriminelët etj., e mes qelisë dhe arkiviolit, zgjedh qelinë. Por, mund të jetë edhe një skenar i tretë me këtë gjest kërkon t'u dërgojë një mesazh bashkëpunorëve të biznesit të tij; kujdes se momenti është mjaft delikat, qëndroni të fshehur sa të mundeni e ngadalësoni trafikun e drogës pasi i kemi të gjithë pas.

KLP kundër Markut: Prokurorët

Hajdarmataj e Çelaj kthehen te Krimet e Rënda



shqyrtimi i çështjes për plotësimin e vendit vakant në Apelin e Krimeve të Rënda me largimin e prokurorit Sheshi, i cili u zgjodh anëtar

i KLP. "Kërkoj që të futet në rend edhe çështja për kaktimin e përkohshëm të një prokurorësi si prokuror në Apelin e Krimeve të Rënda.

Shoqëria përmbartimore JUSTITIA

Shoqëria përmbartimore "E.G. Bailiff Service" me përmbartues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja B, Ap. 1, Tiranë, njofton se më datë 22.02.2019 ora 09:00 - 16:00 në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandimi i lirisë për shfajësim e pasurisë së paluajtshme, ARI, me sipërfaqe 13.000 m², Nr. pasurisë 38/10, Zona Kadastreale Nr. 1669, Vol. 5, Fq. 202, në pronësi të Z. Behar Ibrahim. Flamur Ibrahim, Arben Ibrahim, Eduart Ibrahim, në adresën Fushë Prezë Tiranë me vlerë fillestare në ankand 98.280 (Nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) EURO. Dhe Pasuri e paluajtshme, ARI, me sipërfaqe 8.200 m², Nr. pasurisë 6/4, Zona Kadastreale Nr. 1669, Vol. 4, Fq. 34, në pronësi të Z. Fatmir Kaku, në adresën Fushë Prezë Tiranë me vlerë fillestare në ankand 115.920 (Njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888, email enuar.merko@gmail.com

MASA E SIGURISË

Më 17 janar, Klement Balili, i cili për më shumë se dy vite sfidoi nga arratia institucionet ligjzbatuese, doli i qeshur nga qella ku mbahej dhe po ashtu u shfaq i qeshur në kafazin e xhamtë të Gjykatës për Krime të Rënda, ku dhe u zhvillua seanca gjyqësore për verifikimin e masës së sigurisë "Arrest me burg" marrë në mungesë për të. 48-vjeçari i ashtuquajtur si "Eskobari i Ballkanit", "Baroni i drogës", "Peshku i madh" apo "Magjistari" u shpreh para trupit gjyqësor se ishte i pajfishëm. Në fund të seancës, gjyqtarja Miliana Muça la në fuqi masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj tij.



SHPLLJE ANKANDI

Zyra Përmbartimore "E.G. Bailiff Service" me përmbartues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja B, Ap. 1, Tiranë, njofton se më datë 22.02.2019 ora 09:00 - 16:00 në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandimi i lirisë për shfajësim e pasurisë së paluajtshme, ARI, me sipërfaqe 13.000 m², Nr. pasurisë 38/10, Zona Kadastreale Nr. 1669, Vol. 5, Fq. 202, në pronësi të Z. Behar Ibrahim. Flamur Ibrahim, Arben Ibrahim, Eduart Ibrahim, në adresën Fushë Prezë Tiranë me vlerë fillestare në ankand 98.280 (Nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) EURO. Dhe Pasuri e paluajtshme, ARI, me sipërfaqe 8.200 m², Nr. pasurisë 6/4, Zona Kadastreale Nr. 1669, Vol. 4, Fq. 34, në pronësi të Z. Fatmir Kaku, në adresën Fushë Prezë Tiranë me vlerë fillestare në ankand 115.920 (Njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888, email enuar.merko@gmail.com

Kohëzgjatja e kontratës së koncesionit me PPP ishte parashikuar për 13 vjet

Thumanë-Kashar, qeveria anulon PPP

Ministrja Balluku: Fondi kalon te "Pakti për Universitetin"

Qeveria është ka anuluar partneritetin publik privat për ndërtimin e aksit Thumanë-Kashar. Ministrja e re Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku në daljen e saj të parë para mediave publikoi vendimin për ndërprerjen e procedurës duke theksuar se kjo hapësirë fiskale do t'i dedikohet angazhimit tjetër të qeverisë për "Paktin me Universitetin". Balluku tha se nga projekti i rrugës nuk do të hiqet dorë pasi është një aks i rëndësishëm kombëtar, por ky i fundit do të shihet i integruar edhe me zgjerimin e autostradës Tiranë-Durrës.

"Kam vendosur ndërprerjen e procedurës së partneritetit Publik Privat për Aksin Thumanë - Kashar. Hapësirën e konsiderueshme fiskale të këtij projekti, qeveria do ta dedikojë në funksion të zbatimit të angazhimeve të Paktit për Universitetin, në fushën e infrastrukturës arsimore qoftë asaj fizike e qoftë asaj dixhitale. Natyrisht ne nuk do të heqim dorë nga ndërtimi i këtij aksi të rëndësishëm kombëtar, aq më tepër që projekti është gati. Ky aks ka një rëndësi shumëfishe dhe ne jemi duke studiuar përfshirjen e tij: në projektin e zgjerimit të rrugës Tiranë - Durrës ku bën pjesë edhe rindërtimi i rrugës Tiranë - Ndroq - Plepa në Fazën e parë si dhe ndërtimi i rrugës Kashar - Rrogozhinë në Fazën e dytë"-tha Balluku.

PROJEKTI
Rruga Thumanë-Kashar ishte pjesë e projektit "one billion" dhe iu nënshtrua procedurave të prokurimit pas një oferte të pakërkuar të bërë nga Gener 2, e cila në fund rezultoi edhe si kompania fituese. Në korrik të vitit të shkuar Ministria për Infrastruktura dhe Energjinë njoftoi se Gener 2 kishte fituar procedurën me një ofertë 225.8 milionë euro. Në procedurë morën pjesë katër kompani. Sipas projektit gjurma e rrugës fillon nga Thumana, 150 metra në brendësi të autostradës ekzistuese me 4 korsi, që lidh Milotin me Thumanën në drejtim të Fushë - Krutjes. Gjurma e rrugës vijon me një kthesë djathtë dhe vazhdon e drejtë në fusha deri në afërsi të Fushë-Krutjes. Më pas, me anë të një kthesë të dyfishtë i afrohet Aeroportit të Rinasit. Gjurma e rrugës vazhdon në krah të djathtë të rrugës automobilistike të Rinasit, deri në lidhjen e saj me Autostradën Tiranë-Durrës në Kashar (rreth km të 12 në



Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku

DEKLARATA

Albana Vokshi: "Edi Rama mashtron dhe tallet sërish me studentët. Për Thumanë - Kashar në buxhetin e shtetit nuk është parashikuar asnjë qindarkë këtë vit".



Anulimi i Thumanë-Kashar, LSI: Gënjeshtra e radhës e Ramës

Përmes një deklaratë për mediat, deputetja e LSI, Keledi Mehmetaj ka komentuar vendimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku për ndërprerjen e PPP të aksit Kashar-Thumanë me pretendimin se fondi do shkojë për Paktin për Universitetin. Mehmetaj shprehet se kjo është gënjeshtra e radhës e Edi Ramës, i cili mendon se mund të manipuloj opinionin publik me deklarata mbi para, të cilat nuk ekzistojnë askund. "Kryeministri bashkë me vasalët e tij, ta kenë të qartë që asnjë kërcënim dhe asnjë premtim i gënjeshtërt nuk do të zhbëjë protestën e studentëve. Përkundrazi ata, ndër të tjera, publikisht duhet të përgjigjen për përgjegjësin ligjore që mbajnë mbi shkeljet dhe abuzimet që prej disa kohësh bëhen publike nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për të cilat nësi Grup Parlamentar kemi kërkuar llogari edhe në interpelancë dhe seanca pyetjesh në Parlament"-thotë ndër të tjera deputetja e LSI.



drejtimin Tiranë -Durrës). Dhënia me koncesion /PPP "Për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Aksit Rrugor Thumanë -Fushë-Krutje-Vorë-Kashar", do të bëhet përmes parimit të "Projektit me

Çelësore në dorë". Kushtet thelbësore të kësaj procedure përfshijnë: Objekti i kontratës së koncesionit/PPP: "Ndërtimi dhe Mirëmbajtja e Aksit Rrugor Thumanë-Fushë-Krutje-Vorë-Kashar"

Kohëzgjatja e kontratës së koncesionit/PPP: 13 vjet aktivitetet për t'u kryer nga koncesionari: "Ndërtimi dhe Mirëmbajtja e Aksit Rrugor Thumanë-Fushë-Krutje-Vorë-Kashar" sipas standardeve të

miratuara nga Autoriteti Kontraktues. Burimet e të ardhurave të Koncesionarit: një pagesë disponueshmërie vjetore e pagueshme nga Autoriteti Kontraktues për Koncesionarin, niveli i së cilës do

të përcaktohet në ofertën e paraqitur nga konkurentët. Pagesa e parë e kësaj do të kryhet nga Autoriteti Kontraktues, kur Koncesionari të ketë kryer jo më pak se 25% të punimeve.

Karburante, rafineri dhe restorante ISHTI gjobiti 87 subjekte gjatë 2018-ës

Inspektorati Shtetëror, Teknik dhe Industrial për vitin 2018 ka marrë masa administrative për 87 subjekte dhe gjobat në total arrijnë në 49.35 milionë lekë. Nga publikimi periodik i të dhënave lidhur me kontrollin rutinë dhe masat ndaj subjekteve të gjendura në shkelje, ka një larmishmëri të llojit të aktivitetit që ushtrojnë keto te fundit, duke nisur nga ato më tipiket siç janë pikat e karburantit për të arritur tek kompani që ushtrojnë aktivitet në agropëpunim apo sektorin e shërbimeve. Po kështu ISHTI ka gjobitur subjekte që në inspektimet e mëparshme u ishte lënë detyrë realizimi i një sërë masave ndërkohë që duket se kompanitë nuk kanë plotësuar këto kërkesa. Inspektorati ka gjobitur gjatë vitit 2018 në masën 1.5 milionë lekë subjekte të cilët janë konstatuar se tregonin karburant jashtë normave të lejuara ndërkohë që për raste të tjera kur është konstatuar mungesë dokumentacioni për pajisjet nën presion si dhe mungesë e projektit teknologjik gjobat kanë variuar deri në 500 mijë lekë. Në disa raste janë vërejtur mungesa të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe masa e gjobës sipas parashikimeve ligjore është luhatur në nivele deri në 500 mijë lekë. Nga bilanci 12-mujor rekordin e gjobave dhe vlerës e mban muaji mars kur fokusi ka qenë edhe tek subjektet që përpunonin vajra, kompani në sektorin e agropëpunimit për shkak të mungesës së dokumentit të sigurisë së përgjegjësisë civile apo mungesë të projekteve teknike për pajisjet nën presion apo mënyra sesi kryhen instalimet elektrike. Muaji me më pak gjoba rezultoi të jetë korriku me vetëm 2 të tilla dhe me një vlerë të akumuluar prej 0.55 milionë lekë.



Skema e re për tatim fitimin dhe dividendin

Tatimet: Ja sa do t'ju mbahet nga paga në 2019

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në vijim të informimit për Paketën Fiskale 2019, njofton të gjithë tatimpaguesit për ndryshimet kryesore në ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Sipas Tatimeve norma tatimore e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi sipas nivelit të pagës bruto zbatohet sipas kategorive parasihkon tatimin me 0% për pagën mujore bruto deri 30,000 lekë; 13% për pagën mujore bruto 30,001 - 150,000 lekë dhe 23% për pagën mujore bruto mbi 150,000 lekë. Sipas Tatimeve konsiderohen të ardhura me burim në Shqipëri edhe të ardhurat e një personi jorezident, të përfutura si rezultat i shërbimeve të kryera për një person rezident. Për këto të ardhura, rezidenti që përfiton shërbimin, do të mbajë Tatimin në Burim nga pagesat që do të bëjë për jorezidentin. Do t'i nënshtrohet Tatimit mbi Fitimin edhe çdo person jorez-



ident, i cili nuk është i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar dhe nuk i nënshtrohet Tatimit mbi të Ardhurat. Për përmbushjen e këtij detyrimi, personat jorezidentë do të plotësojnë deklaratën e veçantë të të ardhurave të tatueshme, e cila duhet dorëzuar brenda datës 31 mars të vitit pasues dhe paguajmë tatimin në kohën e dorëzimit. Për efekt të llogaritjes së rezultatit të vitit fiskal, do të konsidero-

hen shpenzime të panjohura shpenzimet për dieta që tejkalojnë 50% të fondit të pagës bruto vjetore. Sipas ligjit në fuqi tatimi mbi Dividentin do të aplikohet në shkallën tatimore 8%. Për fitimet e pasqyruara të realizuara në vitet 2018 e më parë, përfshirë rezervat dhe fitimet e kapitalizuara, kjo shkallë zbatohet me kushtin që: tatimi që i përket fitimeve të pasqyruara të viteve 2017 e më parë, të paguhet brenda datës 30 shtator 2019; tatimi për dividendin për fitimin e vitit 2018 të paguhet brenda datës 20 gusht 2019. Nëse nuk zbatohen kushtet e mësipërme tatimpaguesi do të paguajë 15% tatim mbi dividendin. Ndërkohë që në rast se pasuria e luajtshme ose e paluajtshme që siguron kredinë, ekzekutohet përpara afateve të përcaktuara në ligj për fshirjen e borxhit të keq, provizionet e mëparshme bankare, të njohura si shpenzime të zbritshme, do të vazhdojnë të njihen si të tilla.

NDIHMJA EKONOMIKE PËRFITUESIT

Voltiza Duro

Në 6 muojin e parë të vitit që lamë pas, rreth 53 mijë familje në mbarë vendin u bënë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike. 'Gazeta Shqiptare' publikon sot kategoritë që mund të marrin këtë pagesë nëse plotësojnë kriteret e paracaktuara, mënyrën e aplikimit si dhe ankimmimin e vendimit kur ky i fundit nuk rezulton pozitiv për aplikuesit. Përkatësisht ndihmën ekonomike mund ta përfitojnë: familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme; jetimët të cilët nuk janë në institucione; prindërit e fëmijëve të lindur trinjakë e më shumë njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë. Gjithashtu, në këtë skemë mund të përfshihen edhe viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre; viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrimit të mbrojtjes ose të urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes; si dhe fëmijë të vendosur në shërbimin e kujdestarisë.

APLIKIMI

Familjet pa të ardhura dhe me të ardhura të pamjaftueshme dhe kategoritë e tjera mund të aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike pranë njësive vendore ku kanë vendbanimin. "Për të përfituar ndihmë ekonomike kryefamiljari, së bashku me bashkëshortin nga data 1-10 të çdo muaji paraqiten pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në bashki/njësitet për të aplikuar për ndihmë ekonomike si familje në nevojë me kopjen e kartës së identitetit të aplikantit dhe kopje të kartave të identitetit të anëtarëve të tjerë të familjes që kanë karta identiteti (për fëmijët certifikata) dhe dokumente të tjera të paracaktuara në aktet nënligjore", bën me dije Shërbimi Social Shtetëror. Ndërkohë administratori, në prani të kryefamiljarit, bashkëshortes apo individëve, plotëson online në sistem aplikimin për ndihmë ekonomike, të cilët përmbledhin informacionin për: demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin; llojin e banesës; pasuritë/asetet shtëpiake; të ardhurat nga programet e mbrojtjes sociale. Të interesuarit duhet të kenë parasysh se informacioni duhet të jetë i saktë, pasi në rast të kundërt penalizohen familjet për dekla-

Shërbimi Social Shtetëror: Brenda muajit merret vendimi sipas sistemit të pikëzimit

Ndihmë ekonomike për rreth 53 mijë familje në nevojë, kategoritë përfituese

"Si duhet të aplikoni, cilat janë rastet e përjashtuara"

VENDIMI

"Vendimi për trajtimin me ndihmë ekonomike merret brenda muajit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror nëpërmjet formulës së pikëzuar që përfshin parametra të lidhur me vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve. Formula e pikëzuar merr parasysh karakteristikat e ndryshme strukturore të familjeve urbane dhe rurale", - thekson SHSSH.



FAMILJET E REFUZUARA

Familjet, të cilat janë refuzuar kanë të drejtën e riaplikimit në muajt pasardhës dhe, gjithashtu, ruajnë të drejtën e ankimmimit në lidhje me vendimin e marrë. Ankimmimi bëhet me shkrim fillimisht pranë njësive vendore, e cila është e detyrueshme brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

rim të rremë.

VENDIMI

Lista e familjeve aplikante verifikohet automatikisht nga sistemi elektronik me të gjitha institucionet dhe pasi përfundon ky verifikim në lidhje me saktësinë e informacionit merret vendimi për këto familje. "Vendimi për trajtimin me ndihmë ekonomike merret brenda muajit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror nëpërmjet formulës së pikëzuar që përfshin parametra të lidhur me vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve, të tilla, si: kushtet e jetesës, zotërimi i pasurive, të ardhurat nga remitancat. Formula e pikëzuar merr parasysh karakteristikat e ndryshme strukturore të familjeve urbane dhe rurale", thekson SHSSH. Ky i fundit më tej bën me dije se Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror vendim final së bashku me listën e familjeve fituese me listën e përfitimit dhe familjet jopërfituese me arsyet përkatëse kryetarit të njësive vendore për të njoftuar të gjithë aplikantët dhe për të bërë ekzekutimin e pagesës.

Për të gjitha familjet përfituese është e detyrueshme paraqitja çdo 3 muaj tek zyra e administratorit shoqëror, i cili plotëson deklaratën social-ekonomike dhe e hedh në sistem si dhe verifikon gjendjen shoqërore

KATEGORITË PËRFITUESË:

- Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme
- Prindërit me më shumë se tre fëmijë të lindur njëherësh që u përkasin familjeve në nevojë (trinjakë, katërnjakë, pesënjakë);
- Jetimët të cilët nuk janë në institucione;
- Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre;
- Viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrimit të mbrojtjes ose të urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes.

PËRJASHTIMI NGA SKEMA NDODH KUR:

- Kryen ndarje të qëllimshme të anëtarëve të familjes me përjashtim të rastit vajzë nënë;
- Nuk tërheq në kohë ndihmën ekonomike;
- Refuzon verifikimin e situatës social-ekonomike në familje;
- Fsheh informacionin / kryen deklaram të rremë dhe nuk deklaron ndryshimet e situatës social-ekonomike;
- Refuzon përfshirjen në kurset e formimit profesional ose ofertat e përshtatshme për punë të zyrave të punës dhe nuk rezultojnë punëkërkuar të papunë, apo të vetëpunësuar pranë zyrave të punës.

Informacioni për pranimin apo refuzimin e dhënies së ndihmës ekonomike jepet nga bashkia/njësia administrative, në përfundim të muajit për të cilin aplikimi është i vlefshëm.

dhe ekonomike të familjeve në nevojë, kur futen për herë të parë në skemë, si dhe dy herë në vit të gjitha familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike. Mosparaqitja një herë në 3 muaj dhe moslejimi i verifikimit social-ekonomik në familje largon familjen nga skema e ndihmës ekonomike.

RASTET E PËRJASHTUARA NGA SKEMA

Shërbimi Social Shtetëror bën me dije se nga skema e ndihmës ekonomike aplikantët mund të përjashtohen nëse kryejnë ndarje të qëllimshme të anëtarëve të familjes me përjashtim të rastit vajzë-nënë; nuk tërheqin në kohë ndihmën ekonomike; refuzojnë verifikimin e situatës social-ekonomike në familje; fshehin informacionin / kryejnë deklaram të rremë dhe nuk deklaron ndryshimet e situatës social-ekonomike. Gjithashtu, edhe kur individët refuzojnë përfshirjen në kurset e formimit profesional ose ofertat e përshtatshme për punë të zyrave të punës dhe nuk rezultojnë punëkërkuar të papunë, apo të vetëpunësuar pranë zyrave të punës nuk do të marrin më ndihmë ekonomike. Informacioni për pranimin apo refuzimin e dhënies së ndihmës ekonomike jepet nga bashkia/njësia administrative, në përfundim të muajit për të cilin aplikimi është i

vlefshëm.

ANKIMIMI

Sakaq, familjet, të cilat janë refuzuar se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme kanë të drejtën e riaplikimit në muajt pasardhës dhe, gjithashtu, ruajnë të drejtën e ankimmimit në lidhje me vendimin e marrë. Ankimmimi bëhet me shkrim fillimisht pranë njësive vendore, e cila është e detyrueshme brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës. Pas ezarimit të ankimmimit të njësia vendore, ka të drejtë të ankimojë te Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror dhe në gjykatë. "Për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik, të kryer nga administratori shoqëror, Këshilli Bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% dhe/ose me fonde të buxhetit vendor. Për më shumë informacion mund të referoheni: Ligjit 9365 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, datë 21.04.2016, VKM nr. 955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike" si edhe Udhëzimit nr. 3, datë 17.02.2017, i ndryshuar, për zbatimin e VKM nr 955", nënvizon Shërbimi Social Shtetëror.



Studentët ditën e djeshme gjatë bojkotit të mësimin

"Në master do të paguajmë miliona, pedagogët do të vazhdojnë me abuzimet e tyre"

Studentët vazhdojnë bojkotin: Të rrëzohet ligji i arsimit të lartë

"Pakti për Universitetin, dështim i qeverisë 'Rama'"

Një pjesë e studentëve të universiteteve publike në vend kanë vazhduar bojkotin e mësimin deri në plotësimin e kërkesave të tyre nga qeveria. Ata kërkojnë njëzëri rrezimin e ligjit të arsimit të lartë, në një kohë që shumë të tjerë kanë vijuar mësimin normalisht. Aktualisht bojkoti i mësimin vazhdon në Fakultetin e Histori-Filologjisë, Ekonomikut, Juridikut, Shkencave Sociale, Shkencave të Natyrës, Gjuhëve të Huaja, Gjeologjiku. Ndërkohë, sipas verifikimeve rezultojnë se tek Universiteti Politeknik dhe ai i Mjekësisë bojkoti është ndërprerë dhe studentët u janë rikthyer auditorëve. "Ngujime nuk ka, por aktualisht ka bojkot në të gjitha fakultetet, përveç Politeknikut e Mjekësisë. Rezistenca jonë do të vazhdojë dhe do të mendohe mi ta mbajmë sa më gjatë në jetë këtë formë proteste deri në plotësimin e 8 kërkesave tona dhe rrezimin e ligjit famëkeq të arsimit të lartë. Universiteti është i yni dhe duhet të na ofrojë kushtet minimale që ne dëshirojmë. Pakti për Universitetet është një dështim tjetër i qeverisë 'Rama' dhe me pallavra të tilla nuk na mashτροjnë dot", - tregon një prej studentëve të Histori-Filologjisë për "Gazeta Shqiptare".

"DËSHIMI I QEVERISË"
"Universiteti është i yni dhe duhet të na ofrojë kushtet minimale që ne dëshirojmë. Pakti për Universitetet është një dështim tjetër i qeverisë 'Rama' dhe me pallavra të tilla nuk na mashτροjnë dot", - tregon një prej studentëve të Histori-Filologjisë për "Gazeta Shqiptare".

janë krejtësisht në kundërshtim me frymën demokratike të një universiteti të lirë. "Unë sot jam në grevë, si anëtar i thjeshtë, i barabartë, përtej ndarjeve departamentale, i asamblesë të Fakultetit Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës. Sepse unë refuzoj të bëj mësim në një universitet që kthehet në një regjim kazerem. Sepse VKM e fundit janë krejtësisht në kundërshtim me frymën demokratike të një universiteti të lirë! Sepse unë jam për një model të ri universitar shqiptar: por jo që kriza e protestave studentore të hidhet mbi demokracinë universitare. Nuk ka kuptim që fillimisht na imponohen VKM autoritare dhe pastaj na thuhet hajde diskutojmë për paktin e universitetit!
Pedagogët dhe studentët nuk janë debila! Mos i humbni ditët dhe orët pedagogëve dhe studentëve që duhen harxhuar për dijen dhe shkencën!
Unë sot jam në grevë!", - thekson Fuga.



Studentët dhe duke protestuar për plotësimin e kërkesave



Marku: Po cenohet autonomia e universiteteve

Pedagogët e Filologjikut, grevë njëditore në përkrahje të studentëve

Ditën e djeshme, pedagogët e Fakultetit të Histori-Filologjisë kanë organizuar një grevë njëditore, në shenjë përkrahjeje dhe solidarizimi me studentët. Ata kanë kërkuar plotësimin e disa kërkesave dhe kanë bërë me dije se asambletë e të gjitha fakulteteve do të mbledhen për të marrë një vendim mbi hapat e mëtejshëm. "Është mbledhur asambleja e fakultetit. Asambleja është tërësia e pedagogëve. Ndaj është vendosur që të shpallet një grevë njëditore. Është pjesë e autonomisë, pavarësia në kërkimin



shkencor dhe punët shkencore. Pavarësisht në përbajtjen e mësimdhënies. Janë 3 gjëra elementare. VKM i cenonjë të tria këto", - thekson pedagogu Mark Marku. Ky i fundit shton se në këtë mënyrë po cenohet autonomia

e universiteteve. "Në një VKM thuhet se qeveria do të prodhojë një statut-tip dhe mbi këtë bazë do ndërtohen statutet e tjera. Çdo universitet ka statutin e vet. Ky është cenim direkt i autonomisë. Ne jemi me vetëqindim, por kush do ta bëjë kontrollin e gradave. Ministria bën një VKM për bibliografinë. I bie që ministria do bëjë librat për universitetin, si në shkollat fillore. Ne do caktojmë një ditë se kur do të mbledhemi bashkë me asambletë e tjera të fakulteteve dhe do të dalim me një qëndrim", -tha Marku.

REAGIMI I PEDAGOGËVE

Edhe profesor Artan Fuga ditën e djeshme u është bashkuar studentëve dhe është shprehur se VKM e fundit

Studentët e Shkodrës nisin ngujimin brenda universitetit

Ditën e djeshme, edhe studentët e "Aleksandër Xhuvanit" në Shkodër kanë nisur ngujimin brenda godinës së universitetit. Ata kanë bllokuar fillimisht hyrjen e korridorit me pankarta në duar në të cilat theksohej "Unë jam për ngujim". Më tej të rinjtë janë futur brenda ambienteve të auditorëve dhe kanë thërritur në kor: "Turp, turp, rrëzoni ligjin e arsimit të lartë". Mesa duket, qëndresa e studentëve deri në plotësimin e kërkesave do të vijojë edhe në universitetin e Shkodrës.

Carola Burkert për 'DW': Ligji për fuqinë punëtore kërkon përgatitjen e administratës

Ekspertja: Punë në Gjermani? Lehtësira për personat me shkollim profesional

"Nuk është më e domosdoshme diploma e universitetit"

Deutsche Welle: Ligji i ri për fuqinë punëtore që miratohet nga kabineti gjerman dhe hyn në fuqi më 1 janar 2020 për shumë veta nga Shqipëria e Kosova është si premtim për një jetë më të mirë, punë në Gjermani, e ardhme më e mirë, a mendoni edhe ju kështu?

Dr. Carola Burkert: Ligji i ri për fuqinë punëtore ka njëherë si qëllim përmirësimin e nevojave për fuqi punëtore të ekonomisë gjermane dhe sigurimin e kontrollimit e fuqisë punëtore nga vendet e treta. Ky është sigurisht një sinjal për fuqinë punëtore nga vendet e treta, se tani fokusi është tek punëtorët e kualifikuar, e nëse e ke këtë kualifikim, atëherë vërtet mund të jetë premtuese, një ëndërr që realizohet.

Deri në këtë pikë rruga nuk është e lehtë, ku i shihni lehtësimet për ardhjen e fuqisë punëtore?

Rishtë mund të përmblihen në tri pika - së pari, ai barazon personat me shkollim profesional me ata me universitet, më parë ardhja e fuqisë punëtore lidhej vetëm me ata që kishin kryer studime universitare. Së dyti, lehtësimi do të sjellë vërtet heqja e verifikimit të prioritetit (nuk verifikohet më, nëse për një vend pune ka një kandidat gjerman apo nga BE shën. red.) E reja tjetër është, e kjo mund të konsiderohet si vështirësim, se kërkohet e certifikuar njohja e gjuhës gjermane si kriter për punën apo për ekuivalentimin e diplomave profesionale të huaja. Pra, dy lehtësime dhe një vështirësim.

Shumë veta shprehenin për një zbatim të shpejtë të ligjit, ai do të hyjë në fuqi në janar 2020. Pse kjo vonesë?

Kjo vonesë ka arsytet e saj, zbatimi i ligjit kërkon një adoptim të madh të rregulloreve e neneve që lidhen me të. E dyta, e këtu mund të bëjmë edhe një lidhje me Rregulloren e Ballkanit Perëndimor - duhet që të përgatitet administrata. Ka një ide për krijimin e disa autoriteteve qendrore për të huajt, ku do të përqendrohen procedurat të ndryshme. Ardhja e një numri të ri të punëtorëve të kualifikuar do ta vendosë administratën para sfidave të mëdha, sepse do të ketë një shtim të ri të kërkesave për vizë.

E keni fjalën për ambasadat në rajon...

Të dyja. Njëherë priten të krijohen në Gjermani disa qendra për të huajt në lende të ndryshme, ku do të centralizohen detyrat, tjetra dihet që do të shtohen kërkesat për vizë në ambasadë, e gjitha kjo duhet të përgatitet më parë. Ajo që më kr-

KUSH ESHTË

Dr. Carola Burkert është eksperte për migracionin në Institutin për Studimin e Tregut të Punës dhe Profesionit, një ent studimor i Agjencisë Federale Gjermane të Punës.



Dr. Carola Burkert, eksperte për migracionin në Institutin për Studimin e Tregut të Punës dhe Profesionit në Gjermani

ijon shqetësim është, se që tani ka probleme për të marrë një orar në ambasadë, ka prirje shumë të gjata, sistemet 'online' funksionojnë vetëm pjesërisht. Situata do të vështirësohet edhe më, sepse vërtet që parashikohet shtimi i personelit e zgjerimi i kapaciteteve në ambasadë, por në ligj kjo nuk është përmendur në mënyrë empirike. Aty thuhet vetëm se kjo do të çojë në një rritje të ndjeshme të kërkesave për vizë e shtimin e punës së ambasadave gjermane jashtë.

Po si do ta përballojnë ato këtë fluks të ri, kur ç'është tani ka probleme...

Duhet që të zgjerohen kapacitetet për trajtimin e kërkesave për vizë pune, nga ana tjetër duhet që të futen metoda për lehtësimin e procedurave, si përmes digitalizimit, po ky është vetëm identifikimi i problemit teorikisht.

E praktikisht?

Pikërisht këtu qëndron problemi. Në ligjin për fuqinë punëtore nuk ka deri më tani asnjë përcaktim konkret shifrash, se sa punonjës shtesë duhen për secilën ambasadë, e deri kur duhet të realizohet kjo. Nuk ka asnjë të dhënë për fat të keq. Ka vetëm një vetëdijësim se kapacitetet duhet të shtohen. Por në tekstin e ligjit, thuhet se për shkak të mungesës së prognozave nuk mund të konkretizohet se deri ku shkon shtimi i punës. Kjo do të thotë se as nuk dihet se çfarë përmasash sasiore e kohore ka e gjitha kjo. Kam frikë se sërisht do të kemi probleme si me "Rregulloren e Ballkanit Perëndimor", do të duhet të kalohet sërisht në ngushticën e administratës, sektorit të vizave etj.

A mund të ketë lehtësime, nëse vizat për



PROCEDURA E PERSHPEJTUAR

Sipërmarrja duhet të argumentojë se ka një nevojë urgjente që të zihet vendi i punës në fjalë, prandaj personi adekuat që do të vijë nga jashtë do të kalojë nëpër një procedurë të shpejtë për kërkesën e marrjes së vizës. Do ta quaja si një sportel urgjence, ku punëdhënësi lidhet shpejt me zyrën e të huajve dhe zyra e të huajve me sektorin e vizës.

punë shihen si prioritare...

Ligji parashikon një procedurë të pershpejtuar, në orare dhe procedim, nëse një punëdhënës paguan një

shumë të caktuar dhe arsyeton, se pse duhet një procedim i shpejtë, nëse ndodh kjo, atëherë kjo procedurë e pershpejtuar aktivizohet me afate të caktuara. Për

këtë do të vihen në dispozicion persona kontakti në zyrat e të huajve, mendoj se persona të veçantë kontakti do të ketë pastaj edhe në sektorët e vizave.

Si do të veprohet konkretisht me procedurën e pershpejtuar?

Sipërmarrja duhet të argumentojë, se ka një nevojë urgjente që të zihet vendi i punës në fjalë, prandaj personi adekuat që do të vijë nga jashtë do të kalojë nëpër një procedurë të shpejtë për kërkesën e marrjes së vizës. Do ta quaja si një sportel urgjence, ku punëdhënësi lidhet shpejt me zyrën e të huajve dhe zyra e të huajve me sektorin e vizës.

Ligji parashikon edhe ardhjen me vizë për 6

A KA PENGESA?

Punë në Gjermani? Me ligjin për fuqinë punëtore kjo do të jetë mundur, sikur të mos ishin disa pengesa. Ekspertja Carola Burkert shprehet se për problemet e ligjit, vonesat në ambasadë e punëdhënësin, kjo mund ta lehtësojë situatën.

muaj me shpenzime personale për të kërkuar punë në Gjermani. Nëse e gjen këtë punë, do duhet të kthehesh në vend për të marrë vizën, apo e merr atë në zyrën e të huajve në Gjermani?

Nuk ka një përgjigje të qartë për këtë dhe praktikisht nuk e kam të verifikuar. Por unë e shoh si problematike ardhjen për 6 muaj për të kërkuar punë. Kujdes! Kjo është e lidhur me disa kushte - si njohja apo ekuivalenca e diplomës profesionale, duhen njohuritë e gjuhës gjermane, të paktën niveli B1, duhet të vërtetohet se këto 6 muaj e siguron vetë jetësinë. E duhet thënë, se ky gjashtëmujor si afat ka ekzistuar më parë për ata me shkollim universitar dhe realisht është përdorur shumë pak. Kjo sepse këto kushte nuk janë të lehta për t'u plotësuar.

Pra, edhe një vonesë tjetër...

Problemi e shoh tek ekuivalenca e diplomës profesionale. Kemi kohë të gjatë pritjeje në sektorin e vizave, por të mos harrojmë se problemi tjetër është edhe koha e gjatë që duhet për njohjen e diplomës e certifikatës profesionale. Pra kemi dy paralela, (viza dhe njohja e diplomës, shën red.) që për mendimin tim janë të pasqaruara si duhet, tjetra se si duhet të zbutet mbingarkesa e punonjësve që merren me këto çështje. Një ligj shkruhet shpejt, por ajo që nevojitet është një zgjerim cilësor; i shpejtë e eficient i administratës si brenda, edhe jashtë Gjermanisë. Nevojitet infrastruktura që suksesi i këtij ligji të bëhet i prekshëm.

Ministria e Shëndetësisë: Dokumentacioni dhe kriteret që duhen plotësuar

Voltiza Duro

Deri në 31 janar të këtij viti, mjekët e përgjithshëm dhe ata specialistë kanë të drejtë të aplikojnë për vend pune në qendrat shëndetësore. Aktualisht Ministria e Shëndetësisë ka hapur zyrtarisht garën për rreth 220 vende vakante në 12 qarqe të vendit. Gazeta Shqiptare zbardh sot listat e plota me pozicionet vakante për mjekët specialistë dhe ata të përgjithshëm. "Applikimi është i hapur për të gjithë mjekët që janë në kërkim të një vendi pune dhe që kanë lejen e ushtrimit të profesionit. Kandidati mund të aplikojë për më shumë se një pozicion", thekson

Nis gara për 220 vende të lira mjekësh në 12 qarqe të vendit

MSHMS. Kandidatët e interesuar duhet domosdoshmërisht të zotërojnë lejen e ushtrimit të profesionit. Ata duhet të dorëzojnë pranë zyrës së Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë së Shëndetësisë dokumentacionin e kërkuar nga ora 12.00-14.00 çdo ditë të javës.

Përkatesisht mjekët që do të aplikojnë për këto vende të lira duhet të dorëzojnë: kurrikulumin; diplomën universitare dhe listën e notave; diplomën e specializimit (nëse kanë); lejen e ushtrimit të profesionit nga Urdhri i Mjekut; dëshminë e gjuhës së huaj (nëse

kanë); dëshmi/certifikata të kualifikimeve/ trajnimeve në fushën e shëndetësisë si dhe një fotokopje të Librezës së Punës. Ndërkohë për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.

Në rast se për një pozicion pune paraqitet një kandidat i vetëm, ai do të merret në intervistë për të diskutuar mbi dokumentacionin e paraqitur dhe më pas ministria autorizon direkt drejtorin e qendrës shëndetësore për lidhjen e kontratës së punës me kandi-

datin. "Në rast se për një pozicion pune paraqiten më shumë se një kandidat, atëherë do të organizohet një procedurë konkurrimi me dosje. Për vazhdimin e procedurës kandidatët do të njoftohen me email", thotë më tej Ministria e Shëndetësisë.

VENDET VAKANTE PER MJEKET NE 12 QARQE

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Tiranë

Qarku	Rrethi	Qendra Shëndetësore	Mjek Familje/ Specialistë
Tiranë	Tiranë	NR.4	1 pediater
Tiranë	Tiranë	Zall-Bastar	1 Mjek përgjithshëm/ familje
Tiranë	Tiranë	Peze	1 Mjek përgjithshëm/ familje
Tiranë	Tiranë	Specialitetet Nr.1	1 Reumatolog
Tiranë	Tiranë	Specialitetet Nr.2	1 Okulist, 1 Kardiologe per eko zemre
Tiranë	Tiranë	Paskuqan	1 Mjek Pediater (Konsultori Femijes)

Vende vakant për Mjek Specialistë në Bashkinë Kavajë

Qarku	Rrethi	Qendra Shëndetësore	Mjek Specialistë
Tiranë	Kavajë	Kavajë	1 Mjek përgjithshëm/ familje
Tiranë	Kavajë	Rrogozhine	1 Mjek Imazherist

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Durrës

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Specialisti
Durrës	Durrës	Nr.4	Mjek i përgjithshëm/familje
Durrës	Durrës	Nr.6	Mjek i përgjithshëm/familje
Durrës	Durrës	Nr.8	1 Mjek Konsultori Femije
Durrës	Shijak	Shijak	Mjek Obsteter-Gjinekolog
Durrës	Shijak	Shijak	Mjek Endokrinolog
Durrës	Shijak	Shijak	Mjek Imazherist
Durrës	Shijak	Shijak	Mjek Kardiolog, Mjek Neurolog
Durrës	Durrës	Rrushbull	Mjek i përgjithshëm/familje
Durrës	Durrës	Katund i Ri	Mjek i përgjithshëm/familje
Durrës	Durrës	Gjepalaj	Mjek i përgjithshëm/familje
Durrës	Durrës	Ishem	Mjek i përgjithshëm/familje
Durrës	Durrës	Manez	1 Mjek i përgjithshëm/familje

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Shkodër

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Specialisti
Shkodër	Shkodër	Q.SH Nr. 1	1 Mjek familje 4 Pediater 1 Obsteter-Gjinek
Shkodër	Shkodër	Q.SH Nr. 2	1 Mjek familje 3 Pediater 1 Obsteter-Gjinek
Shkodër	Shkodër	Q.SH Nr. 3	2 Mjek familje 3 Pediater
Shkodër	Shkodër	Q.SH Nr.4	1 Mjek familje 3 Pediater 1 Obsteter-Gjinek
Shkodër	Shkodër	Q.SH Gur i Zi	2 (dy) MPF
Shkodër	Shkodër	Q.SH Dajc	1 (nje)MPF
Shkodër	Shkodër	Q.SH Postribe	1 (dy) MPF
Shkodër	Shkodër	Q.SH Rrethina	2 (dy) MPF
Shkodër	Shkodër	Q.SH Shalë	1 (nje)MPF
Shkodër	Shkodër	Q.SH Velipojë	2 (dy)MPF
Shkodër	Vau Dejës	Q.SH Vau Dejës	1 (nje) MPF
Shkodër	Vau Dejës	Q.SH Bushat	2 (dy)MPF
Shkodër	Vau Dejës	Q.SH Vic-Mnele	1 (nje) MPF
Shkodër	Vau Dejës	Q.SH Shllak	1 (nje) MPF
Shkodër	Vau Dejës	Q.SH Temal	1 (nje) MPF

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Pukë

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Shkodër	Pukë	Q.SH Qafë-Mali	1 (nje) Drejtor/MPF
Shkodër	Pukë	Q.SH Blerim	1 (nje) Drejtor/MPF
Shkodër	Pukë	Q.SH Fierzë	1 (nje) Drejtor/MPF

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Malësi e Madhe

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Shkodër	Malësi e Madhe	Q.Sh Grue Mirë	1 (nje) Mjek familje
Shkodër	Malësi e Madhe	Q.Sh Kelmend	1 (nje) Mjek familje
Shkodër	Malësi e Madhe	Q.Sh Koplik	1 (nje) Mjek familje
Shkodër	Malësi e Madhe	Q.Sh Qendër	1 (nje) Mjek familje
Shkodër	Malësi e Madhe	Q.Sh Shkrel	1 (nje) Mjek familje
Shkodër	Malësi e Madhe	Q.Sh Kasttrat	1 (nje) Mjek familje

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Fier

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Specialisti
Fier	Fier	Q SH LEVAN	1 Mjek Familje
Fier	Fier	Q SH CAKRAN	1 Mjek Familje
Fier	Fier	Q SH FRAKULL	1 Mjek Familje
Fier	Fier	Q SH PORTEZ	1 Mjek Familje
Fier	Fier	Q SH NR 3	1 Mjek Familje
Fier	Fier	Q SH QENDER	1 Mjek Familje
Fier	Fier	Q SH PATOS	1 Mjek Radiolog 1 Mjek Pediater
Fier	Fier	Q SH KURJAN	1 Mjek Familje
Fier	Fier	Q.SH Zharrez	1 Mjek Familje
Fier	Fier	Q SH STRUME	1 Mjek Familje

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Lushnje

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Fier	Lushnje	Nr.1 Lushnje	1 Mjek Familje
Fier	Lushnje	Allkaj	1 Mjek Familje
Fier	Lushnje	Bubullime	1 Mjek Familje
Fier	Lushnje	Nr.2 Lushnje	1 Mjek Familje
Fier	Lushnje	Krutje	1 Mjek Familje
Fier	Lushnje	Terbuf	1 Mjek Familje

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Mallakastër

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Fier	Mallakaster	Ballsh	1 Mjek familje
Fier	Mallakaster	Fratar	1 Mjek familje
Fier	Mallakaster	Aranitas	1 Mjek familje

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Berat

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Specialisti
Berat	Berat	Nr.3	(2) Mjek i përgjithshëm/familje
Berat	Berat	Rroshnik	Mjek i përgjithshëm/familje
Berat	Berat	Vertop	Mjek i përgjithshëm/familje
Berat	Berat	Velabisht	(2) Mjek i përgjithshëm/familje
Berat	Berat	Sinje	Mjek i përgjithshëm/familje
Berat	Berat	Otlak	Mjek i përgjithshëm/familje
Berat	Berat	Lumas	Mjek i përgjithshëm/familje
Berat	Berat	Posnje	Mjek i përgjithshëm/familje
Berat	Berat	Kutalli	(2) Mjek i përgjithshëm/familje

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Skrapar

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Berat	Skrapar	Polican	2
Berat	Skrapar	Qender-Potom-Leshnje	1
Berat	Skrapar	Bogove-Vendreshe	1
Berat	Skrapar	Corrovodë	1

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Berat	Kuçovë	Kuçovë	2
Berat	Kuçovë	Perondi	1
Berat	Kuçovë	Kozare	1

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Kuçovë

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Specialisti
Vlore	Vlore	QSH Nr.1	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	QSH Nr.2	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	QSHNR.3	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	QSHNR.4	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	QSHNR.5	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	NARTE	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	NOVOSELE	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	HIMARE	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	KOTE	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	ARMEN	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	VLLAHINE	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	Brataj	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	Selenice	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	Orikum	1 Mjek familje

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Opinioni **i** Ditës

Ankthi dhe si mund të çlirohemi prej tij?

Nga Miron Çako

Në jetën tonë të përditshme përballim frikë. Frika në vetvete është e mirë, pasi parandalon shumë rreziqe, por ankthi është një frikë e tepruar që buron nga thellësia e qenies sonë të tmerruar, përballë gjërave edhe situatave që nuk i përballon dot forca psikologjike dhe fizike. Nuk janë vetëm fenomenet e frikshme natyrore që shkaktojnë ankth, por edhe sigurimi i gjërave të domosdoshme të jetës (kur ato mungojnë), si ushqimi, veshja dhe strehimi, është një ankth i vazhdueshëm për shumë njerëz, kryesisht për ata që jetojnë në varfëri. Ankthin çuditërisht e gjejmë me tepricë edhe tek njerëzit me mirëqenie të lartë, në shoqëritë me hiperkonsum dhe teknologji të përparuar, siç janë vende të zhvilluara ekonomiksht. Mund të themi se ankthi është bërë një sëmundje mendore e qytetërimit modern.

Ankthi shoqërohet me çrregullimin bipolar, çrregullime në ngrenje, dhimbje koke, çrregullime gjumi e shqetësime të tjera. Për të hequr ankthin, shumë njerëz abuzojnë me substanca qetësuese si antidepressivë apo narkotike, që në të vërtetë e përqesojnë gjendjen e ankthit. Kur ankthi bëhet një stres i vazhdueshëm edhe i pamëna, huëshëm, ka të gjitha gjasat që të kthehet në një gjendje depresive, duke i bërë njerëzit të paafte për jetën normale.

Njerëzit me probleme ankthi, kanë tri deri në pesë herë më shumë gjasë për të shkuar te mjeku dhe të shtrihen në spital për çrregullime psikiatrike, sesa ata që nuk vuajnë nga probleme të tilla. Ankthi nuk krijon vetëm probleme mendore-psikologjike, por edhe ndikon në të tjera komplikacione edhe sëmundje të rënda trupore.

Kris Carr, shkruarë i "New York Times", aktiviste e jetës së shëndetshme dhe një prej të mbijetuarve nga kanceri, thotë: "Nëse mendoni se ankthi juaj, depresioni, trishtimi dhe stresi, nuk ndikon në shëndetin tuaj fizik, mendohuni dhe njerëz. Të gjitha këto emocione shkaktojnë reaksione kimike në trupin tuaj, të cilat mund të çojnë në inflamacion dhe në një sistem imunitar të dobësuar".

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, 1 në 13 veta vuan nga ankthi në botë. OBSH raporton se problemet e ankthit janë bërë çrregullimet mendore më të zakonshme në mbarë botën, me pasojë të mëdha depresive.

Këto statistika nuk vijnë vetëm nga bota e varfër, por siç përmendim edhe më sipër, ankthi po bëhet mbesundues edhe në vende të zhvilluara. Si psh., sipas statistikës nga "Anxiety and Depression Association of America" (Shoqata Amerikane e Ankthit dhe Depresionit) na thuhet se: problemet e ankthit janë sëmundje më e zakonshme mendore në Shtetet e Bashkuara, duke ndikuar tek rreth 40 milionë njerëz që nga mosha 18 e sipër, ose 18.1% të popullsisë çdo vit. Çrregullimi i përgjithshëm i ankthit (GAD) shpesh bashkëndodh me depresion të thellë.

Edhe në Shqipëri, si një vend me shumë probleme sociale edhe pasiguri për të nesërmen, ka shumë ankth tek njerëzit. Kjo vërtetohet, pasi sasia e përdorimit të antidepressivëve,



rritet nga viti në vit. Importet e antidepressivëve si Loram-it, Xanax-it dhe Citalox-it, janë rritur ndjeshëm tri vitet e fundit.

Njerëzit sot në botë kanë kaq shumë ankth sa janë bërë obsesivë, ashtu si na thuhet tek Libri Jobit: "Sepse ajo që më tremb më shumë në bie mbi krye, dhe ajo që më tmerron më ndodh". (Jobi 3:25)

Nga se shkaktohet ankthi? Pavarësisht faktorëve të jashtëm fizikë apo socialë, ankthi është një problem psikologjik, që i vjen njeriut kur ai ndihet i dobët dhe i vetmuar brenda qenies, ose kërkim me egoizëm euforik të qëndrojë i vetëm përpara sfidave të papërballshme të jetës.

E quajmë euforik, sepse ankthi vjen nga djalli (Eusfori), ashtu siç e cilësojmë edhe njerëzit e ndriqar të kohëve tona të cilët me lutje e tyre dhe orientimin shpirtëror kanë ndihmuar shumë njerëz të çlirohen nga ankthi. Shën Pais Agjoritit (1924-1994) thotë: "Kur të shikoni ankth, ta dini se aty ka vënë bishin e tij djalli". Po ashtu shën Porfiri (1906-1991) i cili ishte atë shpirtëror, thotë, duke bërë pyetjen: "Çfarë do të thotë ankth, nerva, sëmundje psikike"? Dhe ai vetë përgjigjet: "Unë besoj se brenda këtyre është djalli. Ne nuk i bindemi Krishtit dhe vjen djalli dhe na trazon".

Djali si një qenie shpirtërore rebel dhe e korruptuar, është në një gjendje të vazhdueshme ankthi, sepse pret ndëshkimin e merituar nga Krishtu, ashtu siç Krishti tha për atë: "Tani është gjykimi i kësaj bote; tani do të hidhet jashtë princit i kësaj bote" (Jn. 12:31-33). Gjithashtu në librin e fundit të Shkrimit të Shenjtë, tek Zbulesa, shkruhet: "Edhe djalli që i mashtronte ata, u hodh në liqenin e zjarrit të shqufirit... edhe do të mundohet ditë e natë, në jetë të jetëve". (Zbul. 20:10). Këtë gjendje të tij të ankthit ai e injektion sheshtas tek njerëzit, veçanërisht tek ata që nuk besojnë në providencën e Perëndisë. (Zbul. 20:10). Këtë gjendje të tij të ankthit ai e injektion sheshtas tek njerëzit, veçanërisht tek ata që nuk besojnë në providencën e Perëndisë. Djalli, si energji mendore, i nxit njeriut egon dhe krenarinë, duke i pëshpëritur në vesh: "ti je 'perëndi'". Në këtë gjendje deliri euforik, kur njerëzit i japin krahë fantazisë që i tejkalon fuqitë e tyre për t'qëndrohen e problemeve imagjinare, vjen djalli dhe injektion në psikikën e tyre ankthin dhe pasigurinë për të

nesërmen, shëndetin, familjen dhe për çdo gjë që u del jashtë kontrollit për shkak të pamundësisë së tyre.

Themi probleme imagjinare, sepse askush nuk e di se çfarë ka rezervuar e ardhmja për ne. Ne njerëzit që lëvizim brenda kohës dhe hapësirës, njohim vetëm të shkuarën edhe të tashmen, sepse e ardhmja është e panjohur për çdo krijesë të arsyeshme. Ajo njohet vetëm nga Krishtu i Kudopranishëm dhe i Gjithëditur, i Cili ekziston përtej kohës dhe hapësirës, njeh gjithçka, si të shkuarën, të tashmen edhe të ardhmen pa asnjë limit, sepse tek Zoti çdo gjë është tani.

Prandaj apostulli Jakovi, nxënësi i Krishtit, thotë për njerëzit egoistë, që bëjnë plane për të ardhmen, pa ia parashtruar ato Perëndisë Transhendent: "Ejani tani ju që thoni: Sot e nesër do të bëjmë këtë e tjetër, edhe do të tregtojmë e do të fitojmë; ju që nuk dini se ç'do të bëhet nesër. Sepse ç'është jeta juaj? Është me të vërtetë një avull që duket për pakëz kohë, e pastaj humbet. Në vend që të thoni: Në dashje Perëndia, edhe në rrofshim, do të bëjmë këtë ose atë. Po tani mburreni me mendjemadhësitë tuaja; çdo mburrje e tillë është e ligë" (Jak. 4:13-16).

Kur njerëzit dështojnë në planet e tyre egoistë, dhe fillon ankthi atëherë djalli e shton në shumë ndjeshmëri edhe pasigurinë për të nesërmen, duke sflitur psikikën e tyre dhe i çon në mbilodhje mendore, në depresione e deri në dëshpërim total, jashtë kontrollit, duke hequr edhe gjëzimin për jetën e deri në vetëvrasje.

Zakonisht kjo taktikë e tij është efiçase tek njerëzit ateistë ose që kanë një besim të pakët për providencën e Perëndisë. Kjo na shpjegon shkakun sepse ankthi është rritur në shoqërinë e sotme, që karakterizohet gjithnjë e më shumë si një shoqëri ateiste, ose gnostike duke krijuar "zota" jo personal edhe indiferent për problemet e njerëzve.

Shën Agustini i Hipos (354-430) thotë: "Nga çfarëdo që të kthehet shpirti i njeriut, nëse nuk drejtohet tek Perëndia, ai shkon në pikëllim, edhe pse gjërat jashtë Perëndisë, në të cilat kthehet, mund të jenë gjëra të bukura". Pyetjes që dikush i bënë shën Paisit: "Jerod, përse shumë

njerëz, ndërkojnë që i kanë të gjitha, ndjehen ankth dhe trishtim?" ai i përgjigjet kështu: "kur shikoni një njeri të ketë shumë ankth, trishtim dhe hidhërim, ndërkojnë që nuk i mungon gjë, të dini diçka. I mungon Perëndia".

Si mund të çlirohemi prej ankthit?

Sipas besimit të krishterë, njerëzit nuk duhet të jetojnë me ankthin e të nesërmen por të jetojnë të tashmen me Zotin dhe të nesërmen duhet t'ia besojnë providencës së Perëndisë, i Cili është një person Hyjnor dhe Trashdëhtar, plot dashuri dhe përkujdesje për gjithë krijesat, madje edhe ato më të vogla, si për zogjtë edhe për lulet, e që më tepër për njeriun e krijuar sipas ikonës së Tij, Krishti si Fjalë dhe Biri i Perëndisë i mishëruar u thotë besimtarëve: "Po mos u shqetësoni pra duke thënë: ç'të hamë a ç'të pimë a ç'të veshim? Sepse gjithë këto i kërkojmë me ngulm kombet; sepse Ati juaj qiellor e di se keni nevojë për gjithë këto. Po kërkoni së pari mbretërinë e Perëndisë, dhe drejtësinë e tij; dhe këto të gjitha do t'ju shtohen juve. Mos u shqetësoni, pra, për të nesërmen, sepse e nesërma do të shqetësohet për punët e saj" (Mt. 6: 31-34).

Kjo mënyrë për të përballuar ankthin nuk është vetëm një aksiomë e krishterë, por njerëzit si para dhe pas Krishtit, e kanë kuptuar këtë nga përvoja e jetës. Epiktiti (55-135) një filozof stoik, thotë: "Nuk mund të ndryshosh të kaluarën, por mund të shkatërosh të tashmen duke u trishtuar për të ardhmen", apo William Cowper (1731-1800): "Ankthi nuk e tua, por zbraz të sotmen me fuqinë e tij, ose "E vërteta është se nuk ka stres ose shqetësim aktual në botë; mendimet tuaja krijojnë këto besime të rreme. Ju nuk mund të pakësoni stresin, prekloni ose shihni atë. Ka vetëm njerëz të angazhuar në mendime stresuese". Wayne Dyer(1940-2015)

Por mësimi i Krishtit ndryshon nga të tillë njerëz të mençur, sepse çlirimi nga ankthi nuk është vetëm një autosugestion psikologjik, por një orientim për mbështetje pa dyshim të providencës e kudondodhur e Perëndisë, të Cilit, Krishti si Biri i Perëndisë e quan Atin e Tij dhe ne

na mëson t'i drejtohemi me lutje: "Aty ynë".

Fjalët e Krishtit për të mos pasur ankth për të nesërmen, nuk duhen kuptuar si "mos puno për të sotmen" sepse ai që nuk punon, nuk duhet as të hajë"(2 Thesal 3:10). Por kur njerëzit punojnë për mbijetesën e tyre duhet të punojnë në sinerghi (bashkëpunim) me Zotin, ashtu si na thotë shën Joani i Kroshtandit (1829-1909) "arsyeja përse ankthi vret më shumë njerëz sesa puna, është se më shumë njerëz kanë ankth sesa punojnë".

Po ashtu ankthi asnjëherë nuk duhet ngatërruar me frikën pedagogjike që ndodhet tek njerëzit si një ndjenje frenuese për t'u shmangur një rreziku, ose për t'i dhënë respektin me nderim atij që i takon, dhe mbi të gjitha Perëndisë, ashtu si na thuhet tek psalmet: "Frika e Zotit është fillimi i diturisë" (Psalmi 110:10), ose siç shprehët shën Agustini për marrëdhëniet shoqërore: "Një frikë e shëndetshme do të ishte një kujdestar i përshtatshëm për qytetarët".

Po ankthin e vdekjes si mund ta përballojmë?

Përveç ankthit të sigurimit të jetës apo të asaj se çfarë mund të ndodhi në të ardhmen, të gjithë njerëzit janë përballë një ankthi që nuk i shmangen dot, ankthit të vdekjes. Vdekja, si një borxh që të gjithë njerëzit duhet ta paguajnë, vjen si hajduti aty ku nuk e pret. Fjalët e Krishtit: "Rrini zgjuar pra, sepse nuk e dini në cilën orë do të vijë Zoti juaj" (Mt. 24:42), janë aktuale në çdo kohë për çdo njeri, pavarësisht moshës edhe rrethanave të jetës ku ndodhet.

Ankthi i vdekjes që është në zemrën e çdo njeriu, ndryshon kur besojmë në vdekjen dhe ngjalljen e Krishtit, që është i pari dhe i vetmi nga njerëzit që e mundi vdekjen në territorin e saj. Ai mori me vete ankthet e vdekjes duke iu lutur Perëndisë Atë: "Abba, o Atë, të gjitha janë të mundura për ty; largoje prej meje këtë kupë; por le të bëhet ju ç'dua unë, por ç'do ti" (Mt. 14:36)

Duke zbritur në thellësi të ankthit njerëzor, Jisui bëhet, për ata që i besojnë ngjalljes së Tij, ngushëllim dhe shpresë për ngjallje, ashtu siç na e sqaron apostulli Pavli. "Sepse, ashtu sikur të gjithë vdesin në Adamin, kështu të gjithë do të ngjallen në Krishtin, por secili sipas radhës së vetë: Krishti, fryti i parë, pastaj ata që janë të Krishtit, në ardhjen e tij. Pastaj do të vijë fundi, kur ai t'ia dorëzojë mbretërinë Perëndisë Atë, pasi të ketë asgjësuar çfarëdo sundimi, çdo pushtet e fuqi. Sepse duhet që ai të mbretërojë, derisa ti vërë të gjithë armiqtë e tij nën këmbët e veta. Armiku i fundit që do të shkatërohet është vdekja. (1 Korintasve 15:22-26)

Të vdekjes mbetet, ajo pishon së qeni një ankth, sepse tashmë në Krishtin e ngjallur vdekja nuk është më një varr i mbyllur, por një derë që hapet për të shkuar përtej kohës edhe hapësirës, në jetën e përjetshme në bashkimin me Zotin. Tani njeriu besimtar nuk ka ankth në përballjen me vdekjen, madje e sfidon, duke thirrur me triumf dhe me ironi therëse: "O vdekje, ku është gjembi yt? O ferr, ku është fitorja jote? ... Po të falënderojmë Perëndinë që na dha fitoren me anën e Zotit tonë Jisu Krisht" (1 Kor. 15:55).

Besimi i krishterë e ndihmon njeriun që ta kapërcëjë ankthin, si një problem psikologjik edhe të mund ta kthejë atë në energji pozitive për të sfiduar problemet e së tashmes, por edhe të vetë vdekjes, që gjithmonë na përgjion në të tashmen, duke bërë çdo ditë pa ankth të mirën për castin që të ka falur Zoti dhe duke ja besuar të ardhmen providencës së Perëndisë Atë, i Cili me anën e Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë, vepron si një të tashmen në të ardhmen dhe të përjetshmen për të mirë tonë, prandaj apostulli Pavli thotë: "Mos kini asnjë ankth për adonjë gjë, por në çdo gjë me anë të lutjes dhe përgjërimit me falënderim le t'i bëhen të njohura kërkesat tuaja Perëndisë" (Filip. 4: 6)

* Përgjegjësi i Zyrës së Katekizimit të Kryepiskopatës K.O.A.S.H.

Grëfhet piktori: Familja, mbështetja më e madhe drejt suksesit

Edlir Reka:

Rusia më dha atë që kam dashur gjithë jetën, emocionet e kupës për pikturën më të mirë

Ja tonalitetet që i ndryshojnë njeriut gjendjen shpirtërore

Egla Xhemali

Për të kjo është periudha më e bukur. I vlerësuar me çmimin e parë për pikturën më të mirë në Rusi, Edlir Reka ndan me ne emocionet e triumfit. Piktori po hon se ajo ditë tanimë është shënuar në kalendarin e shpirtit. Për "Gazeta shqiptare" Reka tregon mënyrën se si u takua me pikturën, tonalitetet që e ndryshojnë gjendjen e brendshme të njerëzve, transformimin që i bën arti, gjërat që nuk do ti linte asnjëherë peng, si dhe sakrificat që ka bërë për t'ia mbërritur kësaj dite. Bluja është ngjyra e tij. Edliri e lidh atë me lirinë dhe qiellin. Përmes pikturave shpaloset një përjetim i brendshëm magjik me qëllim që të përkahet nga të gjithë ata që e duan artin e në veçanti pikturën. Nuk ka kufizim në botën e magjive. Ajo është e paparashikueshme kur bëhet për pleksjet elegante të ngjyrave dhe përcjelljen e ndjesive të ngrohta ashtu sikurse ndihet piktori kur ka përballë telajon e tij. Për gjithçka Edliri i falet familjes. Ata janë bashkë me të në çdo hap suksesi.

Si u "takove" me pikturën?
Në momentin kur mora në dorë letrën e bardhë dhe lapsin, ishte dashuri me shikim të parë. Më tha shpirti, jo mendja, "Ky je ti"... Që nga ai moment takohesha gjithmonë me pikturën tek vendi ynë i preferuar, me letrën e bardhë.

Çfarë tonalitetesh i ndryshojnë njeriut gjendjen shpirtërore?

Për të bërë art që të tjerët ta dashurojnë dhe të bëhen pjesë e tij, si fillim duhet të punojmë me shpirtin tonë, me gjendjen tonë emocionale, të kërkojmë atë çfarë na bën të frymëzohemi dhe të na buzëqeshë shpirti. Dhe është shumë e thjeshtë për të pasur një gjendje shpirtërore të tillë. Mjafton të duash atë që bën, ta bësh me shpirt, me pasion, të ndjesh çdo penel që vendos aty, gjithçka të jetë një ndjenjë e bukur... Nuk është e nevojshme të përdorim mendjen kur zemra është e pastër



dhe e çiltër.

Emocionet e konkursit në Rusi?

Ahhhh drejtin, aventura pesë ditore më e bukur e jetës sime! Është shënuar në kalendarin e shpirtit tim ajo ditë triumfi. Emocion që asnjëherë nuk do mund ta përshkruaj dot me fjalë. Nuk mundem sepse kur ti shkon në majën më të lartë të lumturisë, gjithçka bëhet një abstraksion që nuk ka fjalë në botë që

mund ta përshkruaj. E vetmja gjë që mund të them, është që jam i lumtur pafund që, kam bërë krenar familjen time. Edhe pse nuk kisha parë asnjë prej tyre në Rusi, përsëri i ndieja rrahjet e zemrës së tyre, nga emocionet. Rusia më dha atë çfarë unë kam dashur gjithë jetën, ndenjen e fitores së madhe.

Nëse do të duhej të hidhje jetën tënde në një pikturë, cilat ngjyra do dominonin?

Vetëm ngjyra blu do dominonte. Pak ditë më parë dikush më pyeti, si do e përshkruaje veten me një fjalë? I them qiell. E përshkruaj veten qiell, sepse ai ka lirinë, ka bukurinë, çiltërsinë, patertin. Ka në vete yjet, diellin, hënën, ka gjithçka të bukur. Por, ka dhe vetëtimat. E mendoj shpesh, dhe them se kjo është fjala e duhur për mua. Kam një marrëdhënie të çuditshme me qiellin që më bën ta dua shumë, mbase jemi të dy të lirë dhe të pafund.

Pasioni i ri që të thërret së brendshmi?

Janë dy pasione që më thërresin së brendshmi. Në fakt, kanë kohë që më thërresin po nuk më lë piktura që t'u përgjigjem, sepse bëhet xhe-loze. (qesh) Është aktrimi dhe muzika, që, në fakt, shumë



shpejt do më shikoni edhe në këto dy fusha të tjera të artit. Thjesht ngelet surprizë.

Në çfarë të transformon arti?

Sa më pëlqen kjo pyetje! Të transformon në atë që të tjerët të shohin me syrin "i/e çuditshme. Nuk do mund ta imagjinoja dot kurrë jetën time ndryshe nëse nuk do isha artist. Unë linda bashkë me artin dhe të dy kemi ecur gjer më sot dorë për dorë, dhe kam ndierë lirinë e pafundme. Ja se ç'të dhuron arti: lirinë, çmendurinë, ndjenjen. Ahhh, është mikui me i mirë për mua!

Vendi ku nuk do pikturojë kurrë?

Do thosha në tualet, por ja që e kam bërë. (qesh) Kam pikturuar njëherë brenda në tualet, nga e keqja domethënë s'mund të them dot një vend

ku nuk dua të pikturoj sepse nuk i dihet se ç'të ndodhë. (qesh)

Në retrospektivë, si ka qenë fëmijëria jote?

Fëmijëria ime, uffiff më mirë të mos flasim. Ka qenë periudhë e çmendur. Nëse sot jam ky Edlir i lirë dhe me një shpirt të pastër është vetëm falë asaj fëmijërie plot ngjyra. Me ngjyra të forta, plot jetë dhe pasion. Për këtë gjë, falënderoj familjen time pasi kur panë që një ditë u takova me pikturën, më mësuani si fillim që të pikturoja yllberin. Kjo më bëri të kuptoj shumë.

Çfarë nuk do lije asnjëherë peng?

Nuk e di, s'e kam menduar asnjëherë këtë gjë. Por, them që gjërat e mia më të çmuara nuk do i lija.

Sakrificat më e madhe që të është dashur të bësh?

Ahhhh shumë sakrificat, pa fund, edhe tani që i mendoj më vjen të qaj. Janë shumë dhe i kam bërë për të arritur këtu ku jam sot. Por them se e kam tepruar ka tek shëndeti im. Kam shkuar në konkurs jash-të vendit dhe brenda, në gjendje të keqe shëndetësore vetëm e vetëm që të arrija ato që doja. Por, kur mendoj se çfarë sakrificash kam bërë dhe çfarë kam arritur, jam krenar dhe i lumtur; dhe do vazhdoj t'i bëj, sepse është fillimi. Fillimi i një "Rrugëtimi Frymëzues" (titulli i ekspozitës së parë realizuar në Tiranë)!



Këmbë me shkëlqim? Enca zbulon sekretin e shumë VIP-ave

E nca Haxhia është padyshim një prej këngëtareve më të komentuar në showbiz-in shqiptar. Jo vetëm me këngët e saj që kthehen menjëherë në hite, por dhe me look-un e saj mjaft ekstravagant, Enca di se si të qëndrojë gjithmonë në qendër të vëmendjes. Së fundmi, Enca na ka habitur disi me fotot e videot e postuara në rrjetet sociale. Në njerën prej tyre shihet teksa grimi-erja i aplikon një masë të madhe kremrash në këmbë dhe mund të themi se sapo na zbuloi sekretin se si këmbët e saj dhe të këngëtareve të tjera duken gjithmonë aq me shkëlqim dhe me ngjyrë.



Plas sherri mes Arminës dhe Shkëlzenit, mësoni përse zihet çifti

A rmina Mevlani dhe Shkëlzen Berisha janë ndër çiftet më të komentuar. Ata prej vitesh janë në një marrëdhënie bashkë, por disa muaj më parë ata vendosën që lidhjen e tyre ta çonin në një stad tjetër duke e kurorëzuar bashkëjetesën e tyre me një fejesë. Pas fejesës që realizuan, shumë shpejt pritet që ata të martohen dhe interesi është i madh te publiku. Në një intervistë të fundit, kur u pyet nga gazetarët mbi arsyen që sjell më shumë konflikte në çift mes tyre, Armina ka treguar një detaj të pazakontë. "Do thosha vetëm në kërcim ndoshta, sepse mua më pëlqen shumë të kërcëj, ndërsa atij më pak". Pra mes tyre problemi më i madh, në fakt, nuk është problem.



Pushime në Singapor, ja çfarë i ka ndodhur Alban Ramosajt

A lban Ramosaj është një ndër djemtë më të dashur të show bizz-it shqiptar. Ai është shumë i pëlqyer nga publiku, veçanërisht nga gjinia femërore. Albani është shumë aktiv në rrjetet sociale ku ndan shpesh me fansat poza të ndryshme që tërheqin vëmendjen e të gjithëve. Së fundmi, këngëtar i njohur ka ndarë me fansat eksperiencën e tij të veçantë në Singapor, ku ka shijuar disa ditë pushimi. Në një foto të fundit ai ka zbuluar edhe një incident të vogël që i ndodhi gjatë vizitës në Singapor. Alban Ramosaj shfaqet në foto me një pije në dorë, ndërkohë që sipër tij qëndron një tabelë ku thuhet se nuk lejohet ushqimi apo pijet. Këtë ia vënë në dukje edhe miqtë, veçanërisht fotografi Endrit Mërtiri, i cili e ka shoqëruar Albanin gjatë pushimeve. "Nuk lejohet asnjë ushqim apo pije", i shkruan ai ndërkohë që Albani ia kthen: "Pse më nxorën jashtë". Siç duket ky udhëtim nuk ka shkuar, ashtu siç duhet për Albanin.



I hapën thashetheme për "Don Zhuanin" e Kombëtares, Kejvina flet për atë që e kënaq

K ejevina Kthella është padyshim një prej velinave më të përfolura dhe seksit të showbiz-it. Së fundmi është përfolur mjaft për një lidhje të mundshme mes Kejvinës dhe futbollistit të kombëtares Bekim Balaj, pasi u fotografuan së bashku në një prej club-ëve të Tiranës. E ndërkohë e intervistuar në rubrikën 60 sekondash të "Prive", Kejvina na ka zbuluar mjaft rreth vetes. E pyetur nëse është e dashuruar, Kejvina u përgjigj duke thënë "Mbase," çka na la të kuptonim se ndoshta thashethemet për një lidhje mes velinës dhe "Don Zhuanit" të kombëtares janë të vërteta. Por, ajo që na habiti akoma dhe më shumë ishte dhe një tjetër përgjigje e Kejvinës. Duket se ajo që e kënaq më shumë velinën në jetë janë pikërisht paratë. Çka do të thotë se primare për të tani është karriera dhe të bëjë sa më shumë para.



"Zien" Athina, uniformat blu: 65 mijë qytetarë morën pjesë

Protesta për Marrëveshjen e Prespës, 35 të plagosur, mes tyre 15 policë Qytetarët në shesh sulmojnë gazetarët

Marrëveshja e Prespës bëri që ditën e diel sheshi përpara parlamentit në Greqi të përfshihet nga protesta masive e të dhunshme ku mijëra protestues me flamuj kombëtare kundërshtojnë për çështjen e emrit. Gazetarja Ira London nga Athina në një lidhje telefonike për News 24, është shpreh se të paktën 35 persona kanë mbetur të plagosur nga dita e djeshme, mes të cilëve edhe 15 policë. "Përsëritjet nga Athina, akoma ndjehet marshimet e frikshme. Tashmë kanë filluar edhe publikimet e videoeve. Shumica e protestuesve ishin paqësorë. Pjesëmarrja ishte shumë e ulët nga aq sa pritej. Episodet kanë qenë të gjata, madje janë sulmuar edhe gazetarët. Bëhet e ditur se të paktën 35 persona kanë mbetur të plagosur, mes tyre edhe 15 policë. Policia shprehet se kanë qenë të paktën 65 mijë protestues, ndërsa organizatorët shprehen për të kundërt. Pra, këto ditë ka edhe zhvillime politike krahas ngjarjes së djeshme", u shpreh ajo. Ndërkaq kryeministri i Greqisë, Alexis Tsipras konsideron se marrëveshja e Prespës është marrëveshje historike edhe për Athinën edhe për Shkupin duke theksuar se ratifikimi i marrëveshjes paraqet obligim patriotik. Tsipras në intervistën për gazetën greke "Avgi" akuzoi kryetarin e partisë më të madhe opozitare "Demokracia e Re" Kyriakos Mitsotakis, se po mashtron me opinionin dhe se po bën flirt me të djathtë ekstremë dhe politikës së urretjes për shkak të përfitimeve gjatë zgjedhjeve kuvendare. Ai tha se në secilin shoqëri demokratike qytetarët kanë të drejtë për



Protesta e djeshme në Athinë

protesta paqësore. "Besoj se obligim për secilin është që t'i izolojë grupet ekstreme që përpigjen të manipulojnë me atë protestë dhe ta heqin parullën e urretjes. Mjaft kishim urretje qytetare në histori në këtë vit. Ksenofobët duhet të hiqen me argumente dhe dialog", u shpreh Tsipras. Kujtojmë se ditën e diel shumë qytetarë grekë u mblodhën para parlamentit për të kundërshtuar Marrëveshjen e Prespës me Maqedoninë. Tubimi u zhvillua përpara një votimi të parashikuar mbi mar-

rëveshjen e emrit të Prespës në parlament për këtë javë, të cilin qeveria pret të sigurojë të paktën 151 vota pro. Grupet e qytetarëve kanë intensifikuar një fushatë në mediat sociale për të tërhequr sa më shumë protestues në sheshin "Sintagma" për një protestë kundër "Marrëveshjes së Prespës" midis Greqisë dhe Maqedonisë. Dhjetëra autobusë u morën me qira nga autoritetet lokale, por bashkë me ta kishat dhe manastiret kanë ndihmuar në transportin e njerëzve nga qytetet e tjera

drejt sheshit "Sintagma" në Athinë. Policia rrethoi parlamentin e Greqisë, ndërsa u shënua përplasjet e para me efektive dhe protestuesve. Këta të fundit edhe pse të vegjël në numër, tentuan të hyjnë në pjesë e sipërme të sheshit në drejtim të parlamentit, por kjo gjë u ndalua dhe pengua nga policia. Nga ana tjetër, në këtë protestë në Athinë u paralajmërua se do hapet flamuri që u hap ditën kur u varros Konstandinos Katcifas, i cili mbeti i vrarë pak kohë më parë në Bularat të

GAZETARJA NË ATHINË
"Shumica e protestuesve ishin paqësorë. Pjesëmarrja ishte shumë e ulët nga aq sa pritej. Episodet kanë qenë të gjata, madje janë sulmuar edhe gazetarët. Bëhet e ditur se të paktën 35 persona kanë mbetur të plagosur, mes tyre edhe 15 policë. Policia shprehet se kanë qenë të paktën 65 mijë protestues, ndërsa organizatorët shprehen për të kundërt", - u shpreh gazetarja.

Gjirokastrës pas një shkëmbimi zjarri me forcat RENE. "Protothema" shkroi se pritej një pjesëmarrje e gjerë në këtë protestë, ndërsa fakti se i pranishëm do të jetë dhe flamuri i Katcifas u konfirmua nga organizatorët e tubimit. Amendamentet që u miratuan në 11 janar ishin pjesë e Marrëveshjes së emrit të firmosur në Prespë qershorin e kaluar midis Athinës dhe Shkupit. Sipas marrëveshjes, emri Republika e Maqedonisë ndryshohet në Republika e Maqedonisë së Veriut.

SHKURT
Ramush Haradinaj zbulon pllakën e Ministrisë së Mbrojtjes
Ditën e djeshme nisi procesi i tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ushtrinë e Kosovës. Me këtë rast kryeministri Ramush Haradinaj, ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha dhe komandanti, Rrahman Rama kanë bërë zbulimin e pllakës me mbishkrimin "Ministria e Mbrojtjes", në hyrje të objektit të Ministrisë. Ministri i Mbrojtjes, Berisha me këtë rast tha se sot është ditë e veçantë për FSK-në dhe qytetarët e saj pasi nga sot fillon procesi i tranzicionit të FSK-së në Ushtri. "Është ditë e veçantë për FSK dhe qytetarët e Kosovës, që nga sot ndryshon emërtimi i Ministrisë tonë dhe do të jetë Ministria e Mbrojtjes. Zyrtarisht që nga sot fillon procesi i tranzicionit të FSK-së në Ushtri të Kosovës...", tha ministri, duke falënderuar të gjithë partnerët ndërkombëtarë, SHBA-të, përfaqësuesit e NATO-s etj. Ai tha se procesi i tranzicionit do të jetë gradual, transparent dhe sipas tij është paraparë një plan 10-vjeçari i arritjes së kapaciteteve të mbrojtjes.

Shteti i Palaut tërheq pavarësinë e Kosovës
Ka udhëtuar 25 orë nga Palau për ta gëzuar ministrin e Jashtëm të Serbisë, Ivica Dačić, me tërheqjen e njohjes së Pavarësisë së Kosovës. Presidenti i këtij shteti 21 mijë banorësh në Pacifik, Thomas Tommy Remengesau, i ka dhënë mbështetje dialogut para statusit. Presidenti i Palau, pasi ka ftuar serbët për turizëm dhe not me peshkaqenët vegetarian që nuk hanë njerëz, ka sqaruar vendimin. "Kishim pak informacione për situatën në këtë pjesë të botës. Pararendësi im ka njohur Kosovën pa kuptuar se kjo çështje ka nevojë për një dialog paqësor dhe domethënës". Serbia nuk kishte marrëdhënie me shumë shtete si ky. Dačić thotë se ka përmirësuar gabimin. I pyetur nëse do të ndalonte lobimin në rast të vazhdimit të dialogut, Dačić është përgjigjur kundër. "Megë ju vini nga Shqipëria, t'ju pyes nëse Shqipëria do të ndalojë të llojë për njohjen e Pavarësisë së Kosovës? Nëse Shqipëria nuk ndalon, nuk ndalojmë as ne. Besoj jam i qartë, secili të bëjë punën e tij. Kanë shkruar mediat këtu se do të kemi edhe 4-5 tërheqje tjera, mendoj se ky është deklarim pesimist". Serbia i ka hequr vizat për banorët e Palaos dhe ka firmosur bashkëpunim për rini e sport.

Dialogu me Serbinë, Thaçi i dorëzon ekipit negociator dokumentet
Presidenti kosovar: Jemi në fazën fillestare për të arritur një marrëveshje përfundimtare
Hashim Thaçi i ka dorëzuar ditën e djeshme ekipit negociator dokumentet zyrtare që ndërlihen me procesin e deritanihëm në Bruksel. Presidenti i Kosovës ua ka bërë të qartë bashkëkryesuesit e Ekipit Negociator për të gjitha temat që janë diskutuar deri më tani në Bruksel, në kuadër të fazës së fundit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Ser-

HASHIM THAÇI
"Ua kam bërë të qartë se deri më tani nuk ekziston asnjë dokument i shkruar zyrtar apo draft-marrëveshje e përgatitur nga BE-ja. Kjo është e natyrshme, sepse ne jemi në fazën fillestare të negociatave për të arritur një marrëveshje përfundimtare gjithëpërfshirëse", - ka thënë Thaçi.

bisë. Gjithashtu, ua kam bërë të qartë se deri më tani nuk ekziston asnjë dokument i shkruar zyrtar apo draft-marrëveshje e përgatitur nga BE-ja. Kjo është e natyrshme, sepse ne jemi në fazën fillestare të negociatave për të arritur një marrëveshje përfundimtare gjithëpërfshirëse. Përkundër kësaj,

sapo ta mbaroj pushimin, do të takoj Ekipin Negociator dhe do ua jap edhe në formë të shkruar informacionet e përgjithshme për periudhën e deritashme të bisedimeve. Në këtë proces historik, ne do të punojmë së bashku dhe në koordinim me njëri-tjetrin", kishte deklaruar më herët Thaçi.

Fillon zyrtarisht tranzicioni i FSK-së në ushtri
Zyrtarisht ditën e djeshme ka nisur procesi i tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ushtri. Në ceremoninë e zbulimit të pllakës me mbishkrimin "Ministria e Mbrojtjes", ka marrë pjesë edhe Kryeministri Ramush Haradinaj. Ai ka uruar për zbulimin e pllakës dhe fillimin e tranzicionit të ushtrisë. Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha tha se që nga sot zyrtarisht fillon tranzicioni i ushtrisë. "Që nga sot ndryshon emërtimi i ministrisë. Dua të falënderoj të gjithë që kontribuan në formimin e ushtrisë. Sot është dita ku zyrtarisht fillon tranzicioni i ushtrisë, i cili do të zgjas 10 vjet. Ky tranzicion do të zgjasë 10 vite dhe i tërë procesi do të jetë gradual dhe transparent. Ushtria do të jetë forcë multietnike", - u shpreh ministri i Mbrojtjes së Kosovës.



Zëvendëskryeministri italian, thirrje BE-së të sanksionojë Francën

Di Maio: Kriza europiane e emigrantëve, fajin e kanë francezët për mosndaljen e kolonializmit



LUIGI DI MAIO

"Ne do të ishim hipokritë nëse vazhdonim të flasim për efektet pa kërkuar shkaqet. Nëse sot kemi njerëz që vijnë nga Afrika, për shkak se disa vende evropiane si Franca nuk kanë ndaluar kurrë kolonizimin e Afrikës në kokën e tyre", - tha Di Maio.

dit të emigrantëve në Mesdhe. Besohet se deri në 170 emigrantë, të cilët u larguan nga Libia dhe Maroku në disa anije të rrënuara, mund të jenë mbytur në det javën e kaluar. Tre emigrantë u

shpëtuan nga Marina italiane të premtën jashtë kufirit të Lampedusa. Të mbijetuarit thanë se ishin pjesë e një grupi prej 120 vetë që lundruan nga Libia të enjten. Anija e tyre filloi të fundosej

pasi ata ishin në det për rreth 10 orë. Në mesin e viktimave, sipas organizatave migrante, kanë qenë edhe femijë 2 muajsh dhe të paktën 10 gra. Një tjetër anije që mbante 53 emigrantë kapërceu në Mesdheun perëndimor, sipas mbijetuesit të vetëm të incidentit. Tragjeditë kanë rindezur debatin mbi politikën e linjës së migracionit të mbështetur nga qeveria e krahut të djathtë të Italisë. "Ne do të ishim hipokritë nëse vazhdonim të flasim për efektet pa kërkuar shkaqet. Nëse sot kemi njerëz që vijnë nga Afrika, për shkak se disa vende evropiane si Franca nuk kanë ndaluar kurrë kolonizimin e Afrikës në kokën e tyre", tha Di Maio për turmën.

Ditën e djeshme, zëvendëskryeministri italian ka fajësuar Francën për krizën evropiane të emigrantëve, duke e akuzuar atë për iniciativën e kombeve afrikane me politika "kolonialiste". Ai premtoi të dërgonte çështjen në BE dhe në organizma të tjerë ndërkombëtarë. Luigi Di Maio, kreu i Lëvizjes pesëligjëse anti-establishment dhe zëvendëskryeministri i Italisë, filloi një sulm të ashpër ndaj Francës, të cilën ai argumentoi të fajësohet për shkaqet e natyrshme të krizës së emigrantëve në vazhdim në kufijtë e BE. Di

Maio po fliste në një tubim të dielën, ku nuk harroi të fliste edhe për mbytjet e fun-

Deputetët britanikë përgatisin mocion për të bllokuar Brexit

Brexit, ministri gjerman thirrje Britanisë të gjejë zgjidhje

"Brexit", May prezanton 'planin e saj' të hënën



Ministri i Jashtëm gjerman, Heiko Maas


LARGIMI NGA BE

Britania është planifikuar të largohet nga BE-ja më 29 mars të këtij viti. Ndërkaq pas dështimit të fazës së parë të "Brexit", një grup deputetësh britanikë do paraqesë një projektligj të hënën, i cili do t'i japë parlamentit të drejtën që ta votojë projektligjin e largimit të Britanisë së Madhe nga Bashkimi Europian.

para ligjvënësve ditën e djeshme dhe mediat në Mbretërinë e Bashkuar po ziejnë me spekulimet se çfarë do të përmbajë. Marrëveshja origjinale që ajo negocoi me Brukselin u kundërshtua rrënjësisht. Londra ka kohë deri më 29 mars të arrijë një konsensus rreth asaj se si vendi do të largohet nga Bashkimi

Evropian, me alternativën që të jetë një Brexit pa marrëveshje që ka të ngjarë të shkaktojë kaos dhe të dëmtojë ekonominë britanike. Zyrtarët në Bruksel treguan se ata nuk do të lejojnë ndonjë ndryshim thelbësor në marrëveshjen që ata arritën me kabinetin e Theresa May. Kjo marrëveshje, megjithatë, u kundërshtua

nga deputetët britanikë javën e kaluar në një humbje rekord për një mocion të qeverisë. "Ora po kalon, dhe nëse nuk vjen ndonjë alternativë, ne do të largohemi pa një marrëveshje më 29 mars. Ndosh-ta nëse ajo tha se donte tani të negociante një marrëveshje të tregtisë së lirë, atëherë ajo mund të merrte pak më tej dhe të merrte ndonjë mbështetje në Dhomën e Komuniteteve. Nëse Brukseli thotë se nuk do të rinegojë, atëherë plani i saj është i vdekur", tha Alan Sked nga London School of Economics. Sky Neës thotë se May do të përpiqet të fitojë Partinë e Bashkimit Demokratik (DUP) të Irlandës Veriore për të anashkaluar kontingjencën e mbingarkesës, ndërsa Sunday Times beson se ajo do të kërkojë negociata direkte me qeverinë irlandeze.



Senatoja demokrate, kandidate për Shtëpinë e Bardhë

Kamala Harris, senatorja amerikane, njoftoi dje kandidaturën e saj në zgjedhjet presidenciale 2020, duke u bashkuar grupit të pretendentëve demokratë që shpresojnë të pengojnë Donald Trump nga marrja e një mandati të dytë. "E ardhmja e vendit tonë varet nga ju dhe miliona persona të tjerë që ngrënë zërin për të mbrojtur vlerat amerikane", deklaroi ajo në një video të publikuar në "Twitter". "Për këtë arsye jam kandidate për t'u bërë presidente në SHBA", theksoi Harris. Senatoja 54 vjeç zgjodhi një ditë feste në SHBA, ku kujtohet lindja e Martin Luther King, për të bërë këtë deklaratë, një simbol për këtë vajzë emigrantësh prindërit e të cilës kishin marrë pjesë në lëvizjen e të drejtave civile.

Heiko Maas, ministri i Jashtëm gjerman, i ka bërë thirrje Britanisë që të veprojë në mënyrë serioze dhe të gjejë zgjidhje për Brexitin. Maas ka theksuar përgjegjësinë që ka Britania në këtë proces. Duke iu referuar një interviste për gazetën gjermane "Bild", ai ka thënë në një postim në Twitter: "Theresa May dhe parlamenti britanik kanë përgjegjësi të madhe për të ardhmen tonë në Evropë". Në këtë intervistë, Maas ka thënë se BE-ja do të shqyrtojë me kujdes idetë që ka Britania në këtë proces. Ditë më parë, ligjvënësit britanikë kanë kundërshtuar planin e kryeministres May për largimin e Britanisë nga BE-ja. May megjithatë i ka mbijetuar një vote mosbesimi në Britani, çka i ka mundësuar asaj të punojë drejt planit të ri për Brexit. Britania është planifikuar të largohet nga BE-ja më 29 mars të këtij viti. Ndërkaq pas dështimit të fazës së parë të "Brexit", një grup deputetësh britanikë do paraqesë një projektligj të hënën, i cili do t'i japë parlamentit të drejtën që ta votojë çështjen e largimit të Britanisë së Madhe pa ndonjë marrëveshje me BE-në, shkruan Euronews. Gjatë muajit nëntor të vitit të kaluar kryeministria e tanishme, Theresa May, arriti të sigurojë një marrëveshje me përfaqësuesit e lartë të Bashkimit Europian, për një largim ku do të ishin të pajtues të dyja palët. Mirëpo kjo marrëveshje nuk është përkrahur nga deputetët në Parlamentin britanik, kështu duke u cilësuar si një humbje e rëndë për Kryeministren Theresa May. Nga ana tjetër, kryeministria britanike, prezantoi planin e saj 'B' të Brexit

SHKURT

Përplasen dy autobusë, 22 persona gjejnë vdekjen në Bolivi

Një aksidenti i rëndë ka ndodhur në Bolivi. Të paktën 22 persona kanë humbur jetën si dhe 37 të tjerë janë lënduar si pasojë e një aksidenti midis dy autobusëve. Autoritetet boliviane kanë bërë të ditur se disa nga të lënduarit janë në gjendje të rëndë shëndetësore dhe për këtë arsye mund të rritet numri i personave të vdekur, shkruan Euronews. Në një raport të policisë thuhet se aksidenti u shkaktoi për shkak të tejkalimit të shpejtësisë së kufizuar dhe dyshohet se njëri nga autobusët mund të ketë qenë në kahun e gabuar të rrugës.

Egjipt, 14 të vrarë nga përleshjet mes ushtrisë dhe ekstremistëve

Ditën e diel forcat e sigurisë egjiptiane kanë vrarë 14 ekstremistë dhe kapën një ton eksploziv gjatë një operacioni në pjesën veriore të gadishullit të Sinait. Sipas autoriteteve vendore, forcat e sigurisë egjiptiane patën një konflikt me ekstremistët islamikë në zonat e shkreta të qytetit të El-Arishit. Duke iu referuar zyrtarëve të pidentifikuar të sigurisë egjiptiane, AP raporton se ekstremistët kishin për qëllim të vendosnin bomba përgjatë rrugës në zonat midis El-Arish dhe Shejh Zhuveid.

Shpërthimi në

Meksikë, shkon në 73 bilanci i viktimave

Është rritur në 73 numri i viktimave nga shpërthimi i një tubacioni në Meksikë, ndërkaq 74 persona të tjerë janë plagosur. Omar Fayad, guvernatori i shtetit Hidalgo, ku ka ndodhur shpërthimi, në një konferencë për media të mbajtur në orët e vona të 19 janarit, tha se edhe pesë trupa të pajetë janë gjetur në vendngjarje. Shpërthimi ka ndodhur pas rrjedhjes së karburantit nga tubacioni i gazit. Qindra persona, përfshirë femijë, kishin dalë në vendin ku kishte filluar rrjedhja e karburantit në mënyrë që ta vjedhin atë, pak para se të ndodhte shpërthimi. Prokurori i Përgjithshëm i Meksikës, Alejandro Gertz Manero tha se hetuesit janë duke hetuar se çfarë shkaktoi shpërthimin. Deri më tani nuk ka të arrestuar për këtë ngjarje, ka njoftuar Manero.

Opinion i Ditës

"Kantier" diplomatik me shumë punë të pambaruara

Nga Jorgji KOTE

(vijon nga faqja 1)

... ngadalësinë e veprimeve, sepse kur nxiton, vonon. Gjithësesi, si rrjedhojë e një pune që vazhdon për mbi dy dekada, diplomacia jonë kishte disa objektiva madhorë me afat vitin 2018. Pa mohuar disa hapa dhe demarsh të njohura, sidomos përkushtimin e trupës sonë diplomatike, pa qenë nevoja për analiza të thella, mjafton t'i hedhësh një sy qoftë dhe kalimthi dhe bindesh lehtë se diplomacia jonë i ngjan një kantieri të madh me shumë "sheshe ndërtimi" e me plot me punë të pambaruara. Kësaj, në një farë mënyre jemi "përsëritës" klase me të njëjtat objektiva dhe detyra, por tanimë në kushte më të vështira të jashtë dhe të brendshme.

Ta fillojmë nga objektivi kryesor strategjik, çelja e negociatave të anëtarësimit në BE, kur 2018-ta ishte më ideali. Jo vetëm se ishte "viti i zgjerimit" por dhe sepse nuk kishte zgjedhje, ku zgjerimi drejt Ballkanit të ndikonte mbi elektoratet; Komisioni Evropian miratoi strategjinë e re të Zgjerimit drejt Ballkanit Perëndimor, u zhvillua Samiti i Sofjes dhe ku veç mungesave, edhe rezultatet tona nuk mungonin.

Ndonëse Komisioni dhe Parlamenti Evropian e dhanë viston e tyre falë një pune të madhe të Tiranës zyrtare dhe të Ambasadës/Misionit tonë tejet efikas pranë BE-së në Bruksel "na ngelën" në klasë "për vjeshtë" tre vende të BE-së. Kësaj, mbeti të kënaqeshim të gjithë me sinjalizimin e një date indikative për çeljen e negociatave këtë vit kur... "se"

Tashmë në rrethana tejet të zymta dhe për vetë BE-në, në prag të Brexitit e të zgjedhjeve vendimtare evropiane, ku asgjë nuk mund të parashikohet, kërkohet më shumë se kurrë që shumica parlamentare në bashkëpunim të ngushtë me opozitën të bëjnë çmos për plotësimin e kushteve dhe kriterëve të njohura; edhe pse askush nuk mund të vejë më "bast" se këto negociata do të çelen këtë vit, ca më pak në qershor. Ndryshe, pa plotësimin e këtyre kushteve ka rrezik që të na ikë dhe "treni" i Samitit të Zagreb 2020.

Katalogu i kushteve dhe kërkesave tashmë dihet, atë e përsëriti dhe Komisioneri Hahn në Tiranë më 17 janar në takimim me Kryeministrin Rama. Kryesorët mbeten reformat, dialogu me opozitën që është në nivelin më të ulët, rezultate në luftën ndaj korrupsionit dhe reformës në drejtësi. Veçse kujdes se tanimë, nuk mjaftojnë vetëm ndalimet dhe arrestimet, sidomos të peshqve të mëdhenj, por duhen detyrimisht dhe dënimet të shoqëruara me investime dhe pakësimin e azilkruesve si



kërkesë e prerë dhe prej disa vende anëtare të BE-së për çeljen e negociatave. Pa harruar të shtojmë dhe zgjedhjet tejet të rëndësishme lokale më 30 qershor me të papriturat e tyre të mundshme. Duke vlerësuar drejt rolin vendimtar të diplomacisë parlamentare në këtë proces, Kuvendi ka nisur pa zhurmë dhe bujë demarshet e veta. Mesazhi i kryetarit të tij, zotit Gramoz Ruçi drejtuar homologut rumun, si presidentë e radhës e BE-së shënon një fillim premtues që do të shoqërohet me shumë demarsh të tjera parlamentare.

Puna e dytë e madhe e pambaruara, ndonëse më e reklamuar vitin e kaluar ishin negociatat dhe nënshkrimi i paketës së marrëveshjeve me Greqinë, veçanërisht ajo e Detit dhe heqja e Ligjit të Luftës. Mirëpo entuziazmi fillestar i Kretës dhe Korçës ka rënë mjaft kohët e fundit, sidomos pas incidentit të dhunshëm në Bularat dhe me largimin e dy ministrave të Jashtëm. U fol për një marrëveshje më të mirë dhe për ndryshim epokal, mirëpo deri tani jemi ende në planin e fjalëve, punimeve dhe premtiveve dhe pa ndonjë produkt. Nuk mund të themi më shumë sepe nuk ka pothuajse fare informim publik se ku janë punët, cilat janë pengesat, dhe si do të procedohet më tej.

Për pasojë, marrëdhëniet dypalëshe kanë mbetur në vend numëro. Shqetësimi kryesor është se me ndonjë përjashtim këto marrëdhënie janë kufizuar kryesisht në takime qeveritarësh dhe zyrtarësh të lartë; ndërkohë që në radhë të parë kërkohet krijimi i trustit dhe mjedistit të nevojshëm miqësor. Kjo kërkon aktivizimin e aktorëve dhe faktorëve të tjerë jetikë, duke filluar nga deputetët, gazetaret, akademikët, historikanët, artistët, sportistët dhe njerëzit e thjeshtë e padyshim komunitetin e madh shqiptar në Greqi. Këta dhe jo nacionalistët apo dashakeqësit duhet të "pushtojnë" terrenin e të dy vendeve, nëse duam përparim të qëndrueshëm me Greqinë t'fajne.

Është e rëndësishme të vlerësohet se në prizmin e real politikës dhe "inxhinieringut diplomatik"

Greqia aktualisht është në pozita më të forta negociuese. Ajo ka kapërcyer krizën e rëndë financiare, ka forcuar lidhjet strategjike me SHBA, ka nënshkruar Marrëveshjen me Maqedoninë, ka përmirësuar imazhin, duke synuar të bëhet stabilizatore rajonale e doradorës dhe lidere rajonale, siç ka pretenduar dhe më parë.

Kësaj, tani Greqia nuk ka ngut dhe është më shumë e interesuar për zgjedhjet e reja evropiane dhe kombëtare. E kundërt ndodh me ne, kur marrëveshjet e lartpërmendura dhe sidomos vисто greke për çeljen e negociatave na rrinë mbi kokë si "shpata e Demokleut" përballë një interesi dhe ndjeshmërie të rrallë publike.

Duke kaluar në Kosovë, 10-vjetori i Pavarësisë së saj vështirë të ishte menduar aq i varfer në arritje dhe realizime, apo dhe me hapa prapa. Numri i njohjeve jo vetëm nuk shënoi rritje, por ka pasur e ka vende me tendencë për të tërhequr këto njohje. Liberalizimi i vizave nuk u realizua as këtë vit. Kosova dështoi për anëtarësimin në UNESCO dhe Interpol në mënyrë të përsëritur. Për pasojë, me të drejtë, pavarësisht precedentit jo të mirë që krijoi në bashkëpunimin ekonomik rajonal dhe të aleatit e mëdhenj, Kosova vendosi taksat 100 për qind ndaj importeve serbe.

Me gabimet dhe qëndrimet e saj të gabuara/nxituara Prishtina i kanë bërë disa "dhuratë" të çmuara imazhit dhe diplomacisë serbe në orvatjet e saj për të rikthyer statuskuonë e 20 viteve më parë. Grindjet dhe debatet e paprincipa për dialogun me Beogradin dhe tymueset në parlamentin e Kosovës në qershor janë vetëm dy prej tyre por që i dhanë shansin Serbisë të tregojë gishtin të Kosova!

Pastaj, sikur të mos mjaftonte zhegu i gushtit pa prituri vjeshtë, Presidenti Thaçi nxitoi të shpallte tezën e korrigjimit të kufirit një "shesh tjetër gjigand" ndërtimi, por që fare lehtë mund të kthehet në "shesh lufte" me Kutinë e Pandorës ose efektin domino". Diskutimi i tanishëm rrezikon të hedhë poshtë përpjekjet dhe arritjet e mëparshme historike, me ndry-

shme territori pa kurrfarë transparence, politikë që BE e ka hedhur poshtë këtu e 20 vjet më parë. Propozimi për rifutjen e çështjes së Kosovës në tryezën ndërkombëtare në një format më të zgjeruar se BE-në rrezikon ta zhysë Kosovën dhe rajonin në një rreth vicioz me shumë të papritura dhe kërcënime. Për fat të keq, liderët e Kosovës por dhe të tjerë me ta nuk po e kuptojnë se sot as Rusia, as SHBA-të, as BE-ja dhe as Kosova nuk janë më si 20 vite më parë në çdo aspekt. Më e pakta që mund të ndodhë është që Kosova t'i shtohet "konfliktet të tjera të ngjira" që do t'i interesonte shumë Rusisë.

Shihni dhe intervistat më të fundit të Presidentit Thaçi, kur ai flet vetëm për mundësi dhe ofertime, por jo për risqe dhe humbje, tregon çfarë do të marrë por jo çdo të japë! Kjo ndodh sepse mesa duket politikanë të caktuar në Kosovë nuk po dinë ose nuk duan të bëjnë dallimin që përmend shkrimtari, diplomati dhe politikani i shquar britanik Rory Stuart që "çështja nuk është vetëm se çfarë duhet bërë por dhe a mund të bëhet!"

Në këto mosarritje, veç qëndrimeve agresive serbe, dobësi të BE-së, mangësi të politikës dhe diplomacisë së Kosovës ka pjesën e saj të përgjegjësisë dhe politika jonë e jashtme, duke përfshirë paqartësitë, mungesën e kohezionit dhe unitetit institucional e shfaqur dukshëm dhe me tezen e "korrigjimit të kufijve".

Me Serbinë "skelat" e shesheve të ndërtimit kanë vite që janë atje, por me pak punime, janë ende në fazën e hedhjes së themeleve dhe mesa duket do të qëndrojnë gjatë. Më 2014, kur u bë takimi historik Rama-Vuçiç punoja në ambasadën tonë në Bruksel ku e pamë atmosferën dhe shpresat që krijoi ai takim të ndërkombëtarët. Po tani pesë vjet çfarë ka mbetur prej tij, veç fotove, buzëqeshjeve e ndonjë projekti nëpër të? Kur nga viti 2001 por dhe pas 2014 me Serbinë nuk është nënshkruar asnjë lloj marrëveshje qoftë dhe rutinore, madje as ajo e njohjes së diplomave! Kullmi ishte kur Kryeministria serbe i kërkoi Shqipërisë para një muaji të tërhiqte njohjen e Kosovës!! Po ashtu, kur nën drejtimin e Mogherini, e cila është shfaqur me qëndrime të njëanshme dhe favorizuese ndaj Serbisë, nën maskën e rrezikut plot mirëpo vizita plot pompë dhe bujë e Putinit më 17 janar në Beograd me nënshkrimin e 21 marrëveshjeve javën e kaluar tregoi qartë se Serbia vetëm ka abuzuar me mbështetjen e BE-së dhe se të qëndrimet e kësaj të fundit kanë qenë më tepër dëshirë e mirë por larg realitetit, me analiza, por pa receta që do t'i çojnë në rrugëzgjidhe konkrete dhe dobiprurëse.

Nisur nga sa sipër, nuk mund të ketë shumë pretendime reale as për bashkëpunimin rajonal që ka ardhur në rënie. Procesi i Berlinit me gjithë dëshirën e mirë të sponsorëve politikë, synimet dhe përpjekjet nuk ka shënuar ndonjë risi cilësore sidomos për konkretizimin e projekteve të shumta e të përfollura aq shumë dhe që e bëjnë atë të preکشëm për njerëzit e thjeshtë. Veç të tjerash, më konkretisht kjo duket qartë në mungesën e përparimit lidhur me funksionimin e Fondit Ballkanik të Investimeve me seli në Tiranë. Me gjithë kontributin dhe lehtësitë që ka krijuar Shqipëria, deri tani vetëm 5 për qind e projekteve të tij kanë gjetur burime financimi. Pak a shumë e njëjta gjë ndodh dhe me Zyrën Rajonale Rinore, po me seli në Tiranë, nëismë e Kryeministrave të Shqipërisë dhe Serbisë, etj.

Në këtë kuptim, ndihmesa jonë e moderuar dhe konstruktive ka mbetur më shumë kujtim i një të kaluarë të afërt. Nisur nga roli i tij i kufizuar, edhe emërimi i sekretarës së Përgjithshme të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Majlinda Bregu, është një lajm i mirë, por ngushëllim i vogël.

Së fundi, padyshim që kryesimi i OSBE-së në vitin 2020 është hap dhe arritje për diplomacinë tonë dhe një "kantier" i ri i madh pune për të. Por nuk ka arsye për eufori. Jo vetëm se kemi 28 vjet në OSBE dhe të kryesosh atë pas një periudhë aq të gjatë kohe është më shumë detyrim. Mbi të gjitha, ky kryesim është ndërmarrje e madhe diplomatike, dhe po aq, në mos më shumë përgjegjësi që gjithçka me atë kryesim të ecë mirë, ndryshe mund të kthehet në bumerang.

Ndaj puna në gjithë këto "sheshe ndërtimi" duhet të fillojë menjëherë. Ndryshimi i ekipit politik në Ministrinë e Jashtme t'i japë fund dhe ngërçit institucional, hamendësive dhe pjetjeve jo fort të këndshme pas "pingpongu së dekretive" Në këtë drejtim, drejtuesit e politikës dhe diplomacisë sone të mbajnë parasysh paralajmërimin e Kenedit se "politika e brendshme mund të na mposhtë, por politika e jashtme mund të na vrasë!"

Opinioni *i* Ditës

Pse kemi rritje ekonomike pa zhvillim

PhD. Klodian Muço

(vijon nga faqja 1)

... i duhur për matjen e mirëqenies së popullsisë. Rritja e GDP-së jo gjithmonë shoqërohet me rritjen e të ardhurave të qytetarëve në tërësi.

Sot ekzistojnë një sërë treguesish adekuatë për të matur pikërisht mirëqenien jo në nivel agregat, por në nivel individual duke përfshirë jo vetëm disponueshmërinë e të ardhurave, por edhe të gjendjes shëndetësore, arsimimin, sigurinë, pjesëmarrjen në vendimmarrje, pozicionin e punës, kënaqësinë nga jeta etj.

Përcaktimi i këtyre treguesve përveç zgjerimit të dimensionit ndërmjet mirëqenies dhe përkeqësimit, tregon edhe lidhjen e ngushtë që ekziston midis pabarazisë ekonomike dhe formave të tjera të pabarazisë që ndikojnë në individët përgjatë jetës së tyre.

Pabarazia kur "prek" mundësitë e jetës është dhunim i dinjitetit human; është ndalimi nga mundësitë që secili ka për të zhvilluar kapacitetet e veta.

Kjo pabarazi ka shumë forma dhe po aq shumë pasoja: si vdekje e parakohshme, sëmundje, ofendim, diskriminim, varfëri, pamundësi, mungesë besimi të vetja dhe të oportunitetet që sjell jeta.

Mendon pasojat e atyre që i heqin nga puna në mënyrë të padrejtë, apo të tjerët që humbasin konkurst publike për një vend pune, apo ata që humbasin tenderët që organizohen nga institucionet publike edhe pse kanë dhënë ofertën më të mirë.

Kur shteti stimulon pabarazinë, nuk shkakton vetëm probleme që kanë të bëjnë me dimensionin e portofolit të dikujt, ai shkakton të gjitha problemet e lartpërmendura, redukon kapacitet njerëzore dhe i largon ata nga një jetë sociale normale apo i detyron të emigrojnë nga vendi i tyre.

Për të ndaluar pabarazinë duhet të forcohet me çdo kusht dhënia e mundësive të barabarta duke nisur nga më të vegjlit. E them këtë pasi sot në Shqipëri edhe garat ka marrin pjesë fëmijët, që në thelb janë forma argëtimi, ato shpesh herë trukohen pasi marrëzja e prindërve shkon deri aty sa të paguajnë që fëmija i tyre të jetë i pari.

Në ditët kur zhvillohen provimet e maturës në shumë shkolla shihen po aq prindër sa ka edhe nxënës. Shumë prej tyre mundohen të nxisin kopjimin të fëmijët duke barazuar si ata që mësojnë dhe ata që nuk mësojnë. Kjo demoralizon dhe dekurajon djent.

Sot shumë të rinj nuk lexojnë më se notën e kanë të garantuar nga prindërit apo nga shkolla pri-



vate ku studiojnë. Kjo lloj pabarazie sjell komprometimin e brezave.

Gjithsesi një vend nuk duhet të mjaftohet me investimin në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien komplekse të shoqërisë, por jo vetëm. Pabarazia ekonomike ka efekte edhe në demokracinë e një vendi në tërësi.

Përqendrimi i pasurisë vetëm në pak duar çon në përqendrimin e fuqisë politike. Pra, ndikon në vendimmarrjen e politikave fiskale si dhe në drejtimin që duhet të marrë zhvillimi ekonomik i një vendi në të ardhmen.

Nëse shohim tendencën e orientimit ekonomik të Shqipërisë në 10 vitet e fundit vërejmë se qeveria ka tendencën që shërbimet publike t'ia kalojë privatit me koncesion me kontrata që shkojnë deri në 30 vjet. Po vallë nuk mendohet ndonjëherë se vendet e zhvilluara nuk e kanë ndjekur këtë formë në të kaluarën kur edhe ato kanë qenë vende në zhvillim si ne?!

Rritja e korrupsionit që gjeneron

pabarazi dhe varfëri.

Të gjitha këto arsye na çojnë të mendojmë dhe themi se pabarazia ka efekte shumë negative në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien komplekse të shoqërisë, por jo vetëm. Pabarazia ekonomike ka efekte edhe në demokracinë e një vendi në tërësi.

Përqendrimi i pasurisë vetëm në pak duar çon në përqendrimin e fuqisë politike. Pra, ndikon në vendimmarrjen e politikave fiskale si dhe në drejtimin që duhet të marrë zhvillimi ekonomik i një vendi në të ardhmen.

Nëse shohim tendencën e orientimit ekonomik të Shqipërisë në 10 vitet e fundit vërejmë se qeveria ka tendencën që shërbimet publike t'ia kalojë privatit me koncesion me kontrata që shkojnë deri në 30 vjet. Po vallë nuk mendohet ndonjëherë se vendet e zhvilluara nuk e kanë ndjekur këtë formë në të kaluarën kur edhe ato kanë qenë vende në zhvillim si ne?!

Po ashtu përqendrimi i pasur-

isë në pak duar çon në disa raste deri në vendimmarrje që jo vetëm varfërojnë ekonomikisht një vend, por edhe e dëmtojnë nga pikëpamja shëndetësore individët. Për ta kuptuar këtë mjafton të shohim cilësinë e miellit që importohet në Shqipëri; cilësinë e kimikateve apo produkteve kancerogjene që janë në qarkullim dhe përdoren në bujqësi apo blegtori; cilësinë shumë të ulët të ilaçeve.

Mishi dhe nënproduktet e tij, djathi, vaji i ullirit e shumë produkte të tjera jo vetëm që kanë një cilësi të ulët e në disa raste nuk duhen as konsumuar, por edhe kushtojnë në Shqipëri më shtrenjtë sesa në vendet e zhvilluara. Ndërkohë që Shqipëria është një ndër vendet më të varfra në Europë me një rrogë mesatare bruto prej 419 euro sa 1/6 e mesatares së BE-së.

Natyrë ka qenë shumë zemërgjerë me ne po përsëri pabarazia e stimuluar nga drejtuesit politik ndër vite na ka çuar që nëntoka të shfrytëzohet nga të pasurit në mënyrë makabre. Kemi qytete të mrekullueshme si Saranda apo Ksamili që adhurohen nga turistët e mund të kishin turistë 12 muaj viti pasi ka me mijëra pensionistë që lënë Italinë, Gjermaninë apo Norvegjinë për të jetuar në qytete si Saranda apo Ksamili. Problemi qëndron përsëri te fakti që sistemi sanitar shqiptar lë për të dëshiruar.

Për të konkluduar mund të them se politikbërësit duhet ta kenë të qartë faktin se mirëqenia është një e drejtë, pabarazia është padrejtësi.

HOROSKOPI

DASHI

Është koha që të ndihmoni një mik ose bashkëpunëtor, i cili mund të jetë duke luftuar me një detyrë të profilit të lartë. Asgjë nuk do t'ju bëjë të ndiheni më mirë se sa të ndani idetë dhe sugjerimet tuaja se si mund t'i bëni gjërat të funksionojnë më mirë.

DEMI

Ju jeni mësuesi më i mirë i vetes tuaj, prandaj mos e harroni këtë kur hasni një situatë të panjohur. Ju duhet të përfitorni nga ky episod duke e bërë atë një mundësi për të mësuar; bëni pyetje të vështira dhe mos merrni një po ose jo të thjeshtë për një përgjigje.

BINJAKET

Skema juaj e fundit është e rëndësishme, dhe ju jeni duke iu afruar një pike pa kthim sa i përket angazhimeve tuaja. Nëse doni që gjërat të vazhdojnë me sukses, ju duhet të çmontoni veten në këtë proces. Nëse jo, atëherë zbrisni nga anija menjëherë, ose rezakoni të hynin në ujëra të thella.

GAFORJA

Duhet të jeni në gjendje të ndjeni një fillim të ri që vjen së shpejtë në jetë tuaj. Ju jeni padyshim gati për çdo gjë dhe keni nevojë për stimulim. Mos u shqetësoni, sepse kjo po vjen shumë shpejt! Mbahuni fort dhe prisni!

LUANI

Nëse ndiheni fajtor se bëni shumë pazar, apo e tregoni me ushqimin, sot duhet të përqipeni ta ndërprisni këtë. Është koha për t'i dhënë fund aktiviteteve të tepruara dhe t'i ktheheni një mënyrë më të thjeshtë jetese të paktën për momentin.

VIRGJERESHA

Në një mjedis biznesi apo shkolle, po i afroheni një pike kritike, por ju duhet të shikoni këtë ditë si çdo ditë tjetër. Gjëja më e keqe që mund të bëni tani është të lejoni veten të frikësoheni nga disa prishmëri. Nëse i shmangni gjërat, do të humbni perspektivën dhe mund ta shihni veten lirë.

PESHORJA

Nëse luani kartat tuaja në mënyrë të drejtë, dita e sotme mund të shndërrohet një pikë kthesë masive për ju. E gjitha varet nga ju kështu që rrethojeni veten me njëzëz kreativë dhe romantikë sa më shumë që mundeni. Një derë po hapet për ju.

AKREPI

Sot do të jetë një ditë e qetë, prandaj mos prisni shumë sfida. Kjo është një mundësi e madhe për ju që të vlerësoni disa arritje të kohëve të fundit në jetën tuaj. Ato ju kanë vënë në një pozicion të lakmueshëm. Ju duhet të planifikoni hapin tuaj të ardhshëm me shumë kujdes.

SHIGJETARI

I keni hapur vetes një derë në dashuri. Mundohuni të mos nxitoni në gjërat që bëni. Kurioziteti juaj duhet të frenohet në një farë mase. Sa i përket financave, duhet të tregoni kujdes me një kredi ose hua sepse mund ta zhyni veten në probleme.

BRICJAPI

Gjërat kanë qenë të turbullta kohë e fundit sa i përket emocioneve. Relaksimi ndonjëherë është më i rëndësishëm se shpejtësia. Lehtësoni pedalin e gazit në dashuri dhe merrni një rrugë dytësore për të arritur në destinacionin tuaj.

UJORI

Sot mund të takoni disa persona me të cilët keni shumë kohë pa u parë ose me të cilët mund të keni humbur kontaktet. Sa i përket punës, do të ishte mirë që të mendoni edhe alternativa të tjera që të qëndroni si uji që nuk qarkullo.

PESHQIT

Të qenit i butë është mirë, por sot është një ditë kur pajtësit duhet të ofroni sa më shumë ide origjinale. Ju keni shumë gjëra të mira për të thënë, dhe është koha që ju të jeni udhëheqës. Njerëzit rreth jush do të jenë më të hapur ndaj jush.

KAPITENI I SKËNDERBEUT




Radas: Nuk jemi aty ku duhet, por do luftojmë për titullin

Kapiteni i Skënderbeut, Marko Radas, nuk e fsheh që korçarët kanë probleme në këto momente dhe nuk janë në maksimumin e tyre. Sipas tij, ekipi është ende mbrapa në krahasim me atë që pritet, por në një javë do të synohet të kthehet në nivelet e kërkuara për t'u përballur me Partizanin në kampi-

onat e për të synuar përsëri fitoren e këtij titulli. "Mendoj që nuk jemi ende në nivelin e duhur, por kemi edhe një javë, është kohë e mjaftueshme për të arritur aty ku kemi dëshirë. Do të luftojmë deri në momentin e fundit për kampionat", tha ai për "Ora News". Problemet e Skënderbeut i di edhe Shehi, i cili ashtu si

kapiteni i ekipit së tij, mendon se skuadra nuk është ende aty ku pritet. "Problem është që nuk kemi inatin e futbollit para portës, që të jemi 100% gati për të konkluduar. Por pavarësisht shumë ndryshimeve, e dimë që kemi vështirësi, është tranzicion që u ndodh skuadrave të mëdha kur largohen shumë lojtarë, kurrësi nuk heqim dorë nga objektivat madhorë, siç i ka hije këtij klubi", theksoi trajneri i korçarëve.

VALSII SULMUESVE



Ndërkohë, Higuain ikën te Çelsi e Pirotek te Milani

Nëse tek Milani kanë gjithçka gati për ditën e sotme, që do të jetë dita e Kristof Pirotek, nga ana tjetër, edhe në Londër priten zhvillime. Siç raportojnë mediat italiane, nesër "El Pipita" do të jetë në Londër për të kryer ritualin e vizitave mjekësore, para se të firmosë kontratën e të rikthet me teknikun e tij, Mauricio Sarri, ku shkëlqyen të dy tek Napoli. Ndërkohë, tek Milani këtë largim do ta rikuptojnë, duke përzantuar polakun Piontek.

ndonëse me kampionatin e rifilluar, adaptimi i elementëve të rinj bëhet shumë i vështirë. **FIRMOS DILAVER DUKA**

Dilaver Duka është zyrtarisht një lojtar i Partizanit. Mesfushori me tipare sulmuese iu bashkua të kuqve në Antalia, ku zhvilloi fazën përgatitore dhe më pas luajti një pjesë loje ndaj Dinamos së Zagberit. Duka është një kërkesë e trajnerit Gega dhe drejtuesit kanë vendosur ta kënaqin teknikun e tyre.

Rritje e ndjeshme e pagës dhe më shumë akses në merkato, dy pikat parësore të akordit të ri



Jeton Selimi

Goditja më e rëndësishme, Partizani rinovon me Gegën

Trajneri kishte vetëm një marrëveshje 6-mujore

Partizani është hedhur në merkato për të plotësuar nevojat aktuale të grupit, por më parë duhet të bindte strategun Gega për të vijuar punën në krye të stollit të kuq. Duket paksa paradoksale, por trajneri Skënder Gega e ka menduar të paktën njëherë në këtë periudhë në duhet ta vijojë apo jo punën e tij në krye të Partizanit. Dhe paradoksi qëndron se të kuqtë janë kryesues dhe arkitekti i këtij suksesi është padyshim ish-mbrojtësi dhe kapiteni i viteve '80. Por, pas kthimit nga Turqia janë vënë pikat mbi "i". Gega ka marrë "bekimin" e drejtuesve për të vijuar punën e tij dhe këta të fundit i kanë ofruar një kontratë më të mirë.

SITUATA

Skënder Gega pranoi detyrën për të udhëhequr Partizanin dhe firmosi me të kuqtë një kontratë formale, pasi kontrata e vërtetë ishte ajo që drejtuesit dhe tropojani bënë mes tyre. Në fakt, më shumë sesa një kontratë, ka qenë një pakt i shtrënguar mes palëve: 6 muaj për të parë sesi do të shkojnë gjërat dhe më pas do bisedohet sërish në janar, ashtu siç edhe ndodhi.



DYSHIMET

E vërteta e transferimit të Vasil Shkurtajt te Kukësi ka një prapaskenë. Sulmuesi ka pritur deri në fund Partizanin. E joshite aventura me të kuqtë për shkak dhe të afërimitit që ka me trajnerin Gega. Ky i fundit ka shpresuar më kot që drejtuesit t'i

sjellin Shkurtajn në ekip, që në fund ka firmosur për Kukësin. Kjo ka bërë që në kokën e trajnerit të ngrihen dyshimet e para në lidhje me të ardhmen e tij në stollin e kuq. Nëse nuk i plotësohen kërkesat e merkatos, atëherë përse duhet të vijonte punën, kur në fund të se-

zonit llogaritë do t'i jepte ai? Por pas një takimi mes tij, presidentit Demi dhe drejtorit Rama një ditë përpara nisjes për në Antalia, janë sheshuar dhe dyshimet e fundit rreth.

KONTRATA E RE

Edhe një vit e gjysmë më shumë në krye të Partizan-

it. Një rrogë shumë e mirë dhe mbi të gjitha më shumë akses në vendimmarrjet e merkatos. Këto janë pikat kryesore të kontratës së re, të cilën Gega dhe klubi e kanë firmosur dy ditë më parë. Shifrat nuk bëhen të ditura, por gazeta mësoi se termat ekonomike janë mëse të kënaqshëm dhe bëhet fjalë për një pagë prej rreth 4 mijë eurosh në muaj.

MERKATO

Me firmën e Gegës ka mbaruar vetëm një pjesë e merkatos. Trajneri ka kërkuar që në fillim një sulmues dhe një mbrojtës të djathtë, pozicione që për momentin ende nuk janë dubluar. Drejtuesit kanë pasur disa alternativa, por për njëherë arsye apo tjetër, kanë dështuar të sigurojnë elementët e nevojshëm, ndërsa ndeshja me Skënderbeun është në prag. Gjithsesi, Partizani dhe të gjitha klubet e tjera kanë kohë deri më 31 janar të plotësojnë ekipet,

SULMUESI LË ÇEL SIN

Tashmë mund të quhet e kryer. Sulmuesi Alvaro Morata mund të quhet një lojtar i Atletiko Madridit. Akordi mes Çelsit dhe klubit madrilen është arritur dhe pritet vetëm firma. Nga ato që bëhen me dije nga media angleze "Sky Sport", sulmuesi mund të quhet pjesë familjes "Rohiblanco". Akordi mes tri palëve është gjetur lehtësisht edhe në ditët në vijim, pritet që

Firma formalitet, Morata është i Atletikos



Morata të shkojë në vendin e origjinës së tij që është Madridi. Operacioni mund

të quhet i mbyllur, pasi lojtari do të shkojë në huazim dhe në fund të sezonit Atletiko, duhet që të paguajë 50 deri në 55 milionë euro në varësi të bonuseve. Ky transferim i hap derën kalimit të Higuain te Çelsi dhe Piontekut te Xhenoa. Pra, një lëvizje e tillë ka bërë që të ndryshojë disi "klima" në merkaton e janarit.

SULMUESI SUEDEZ

Zlatan Ibrahimović ka qenë një nga personat që i ka qëndruar më afër Pol Pogba në vitet e tij te Mançester Junajtid dhe e kupton shumë mirë francezin dhe nevojat që kishte ai për të qenë i lirë nga disiplina taktike që kërkonte Zhoze Murinjo. Pogba ka gjetur përsëri ritmin e tij që kur skuadrën e drejton Ole Gunar Sol-skjaer dhe për Ibrën, kjo është arsyeja pse ai po tregon përsëri futbollin më të mirë të viteve të fundit. "Ka

Ibra: Largimi i Murinjos çliroi Pogban

disa lloj lojtarësh që kanë nevojë të ndjehen të lirë të bëjnë atë që dinë nën disiplinën e një trajneri", komentoi sulmuesi suedez për ESPN. "Sigurisht trajneri ka taktikën e tij, por disa lojtarë kalojnë këto limite dhe duhet t'i lësh të lirë. Mendoj se Pol është një prej tyre. Ai nuk ndjente besimin e trajnerit dhe si rrjedhojë as trajneri nuk e ndjente nga Pol. Është e vështirë të

tregosh veten kur nuk ke besimin e trajnerit dhe nuk ke më energji e motivim, edhe Zhoze ndjente të njëjtën gjë nga Pol. Janë gjëra që ndodhin, jo të gjithë mund të shkojnë mirë bashkë. Vjen një moment kur duhet të ikë njëri apo tjetri. U largua trajneri dhe tani Pol është më i lirë", tregoi Ibrahimović se si ish-shoku i tij i skuadrës ka gjetur përsëri formën më të mirë.

